



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 425 Akti

Nr. 470 Vendimi
Tiranë, më 1.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 22.10.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ajola Prenci**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, aktualisht Lezhë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, aktualisht Lezhë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b”, të pikës 7, të nenit 3 dhe pikës 9, të nenit 3, të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Ajola Prençi, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 9.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.01.2020, deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijeni për trupin gjykues, si dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

6. Komisioni, në datën 5.10.2021, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi, për të tria kriteret e rivlerësimit: për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 5.10.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Në datë 7.10.2021 subjekti kërkoi analizën financiare të kryer nga Komisioni, e cila brenda të njëjtës ditë, iu vendos në dispozicion. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni (datë 15.10.2021), subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike. Gjithashtu, Komisioni administroi edhe shpjegimet dhe provat shtesë të depozituara nga subjekti në datën 20.10.2021.

8. Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në funksion të rezultateve të hetimit, konstatoi se në qëndrimin e subjektit referohej një parashtrim specifik me përmbajtje kërkimi për thirrjen e huadhënësve në cilësinë e dëshmitarëve dhe konkretisht: “... nëse shpjegimet e dhëna nga ime, në lidhje me këtë çështje, nuk konsiderohen të plota, atëherë kërkohet nga Komisioni të thërresë dhe të pyesë, në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit Xh. (Xh.) C. Th. dhe L. F. Th., banues në fshatin D., Shkodër ...”. Lidhur me këtë parashtrim, Komisioni pas analizës së situatës në tërësi për sa referohej/kërkohej nga subjekti, e informoi atë se nisur nga tërësia e veprimeve hetimore të Komisionit, qëndrimin të saj, si dhe dokumentacionit të administruar për huadhënësit të cilët kanë deklaruar para noterit publik në vitet 2004 dhe 2019, parashtrimi i saj me përmbajtje kërkimi, dukej i panevojshëm, bazuar në gërmën “a”, të pikës 6, nenin 45, të ligjit nr. 84/2016.

9. Në datën 19.10.2021, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 22.10.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

11. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ajola Prençi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 22.10.2021, për të rifilluar në datën 26.10.2021 për shpalljen e vendimit.

12. Seanca për shpalljen e vendimit u shty (për të cilën u njoftua edhe subjekti), për shkak se në diskutimet përfundimtare për vendimmarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit në datë 25.10.2021, nga trupi gjykues u vlerësua verifikimi i vërtetësisë së aktit - kontratë huadhënie nr. ***rep., datë 23.11.2004, pranë noterit publik. Ky proces u pasqyrua në procesverbalet përkatës, datë 25.10.2021 dhe datë 27.10.2021, të cilat janë administruar në dosjen e hetimit administrativ.

13. Në datën 29.10.2021 në diskutimet përfundimtare për marrjen e vendimit, trupi gjykues vlerësoi se nuk kishte arsye ligjore për rihapjen e hetimeve dhe në këto kushte vijoi me vendimmarrjen, duke e njoftuar njëkohësisht edhe subjektin e rivlerësimit se shpallja e vendimit do të jetë në datën 1.10.2021.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Ajola Prençi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot datë 21.01.2019, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi, e cila ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë e në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) argumentimet e dhëna me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi, si vijon:

¹Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

1. Apartament në pronësi me sip. 75 m² në adresën: bulevardi “****”, lagjja “****”, pallati ***, kati i ***-të, Bashkia Shkodër, blerë në vitin 2004, me çmimin 2.450.000 lekë, blerë me kursimet nga të ardhurat dhe kredi bankare. Vlera është 2.450.000 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente².

1.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar: Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për apartamentin me sip. 75 m², në Shkodër, blerë me çmim 2.450.000 lekë, sipas kontratës së blerjes nr. ***, në datë 24.11.2004, ndërkohë që rezultojnë se kredia është marrë nga UBA, në vlerën 2.000.000 lekë, në datën 22.1.2005.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

1.2 Komisionit nga verifikimi i DPV-ve i rezultoi se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2004 me përshkrim: “... shtëpi banimi (apartament) me sip. 75 m²...e hipotekuar, blerë nga S.H., në vlerën 2.450.000 lekë, krijuar në 24.11.2004, në bashkëpronësi me bashkëshortin”. Komisioni konstatoi se subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar se ka marrë kredi në shumën 2.000.000 lekë, në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë (UBA) Shkodër, për të blerë apartamentin.

1.3 ASHK-ja³ ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie me nr. ***, në z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi (Ymeri) dhe të bashkëshortit P. P. . Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se kjo pasuri është bllokuar në datën 7.2.2004 në favor të hipotekës dhe, më tej, është liruar në datën 12.1.2008. Sipas kontratës së shitjes së kësaj pasurie nr. ***, datë 24.11.2004, rezultoi se pasuria është blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nga shtetasit S. dhe F. H., në çmimin 2.450.000 lekë. Në kontratë është parashikuar se çmimi është likuiduar plotësisht mes palëve jashtë zyrës noteriale dhe blerësit kanë marrë pronën në pronësi të tyre të plotë.

1.4 FSHU-ja⁴ nuk ka konfirmuar kontratë për furnizim me energji elektrike në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Subjektit i është kërkuar⁵ të depozitojë kontratën e furnizimit me energji elektrike me FSHU-ja për këtë pasuri dhe librezën përkatëse që i përket kontratës. Subjekti në përgjigjet e saj, ka depozituar: (i) kontratën e furnizimit me energji elektrike me OSHEE-në; (ii) librezat përkatëse të pagesave të energjisë elektrike në vite për apartamentin me adresë në “Bulevardin ****”, lagja “****”, pall. ***, k. ***, Bashkia Shkodër; (iii) pagesat bankare të bëra nga llogaria e pagës së subjektit për OSHEE-në (kjo për periudhën e pandemisë).

1.5 UKT Shkodër⁶ nuk ka konfirmuar kontratë për furnizimin me ujë në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Subjektit i është kërkuar⁷ të depozitojë kontratën për shërbime Ujësjetës – Kanalizime për këtë pasuri dhe librezën përkatëse që i përket kontratës. Subjekti në përgjigjen e saj ka deklaruar se: “Në lidhje me Kontratën e Furnizimit me ujë me Ujësjetës Kanalizime Shkodër, ju sqaroj se unë nuk e disponoj atë, por disponoj vetëm një dokument që ka të bëjë me vendosjen e matësit të ri në datën 3.7.2013, për banesën time. Theksoj se as unë, por edhe bashkëshorti im nuk mbajmë mend që të kemi patur kontratë të formalizuar, përndryshe do t`jua kisha vënë në dispozicion ashtu si kontratën e energjisë elektrike”. Komisioni, nga verifikimi i librezave të ujit, konstatoi se pagesat kanë filluar prej muajit dhjetor të vitit 2004.

1.6 Për sa më sipër, në tërësi lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika. Gjithashtu, u vërejt

²Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴Me shkresën nr. ***, datë 15.5.2020.

⁵Me pyetësorin nr. 2, datë 15.6.2021.

⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁷Me pyetësorin nr. 2, datë 15.6.2021.

se përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

1.7 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim i kësaj pasurie janë: (i) kursimet, ndër vite, nga të ardhurat; dhe (ii) kredi bankare.

1.7.i Në lidhje me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat

Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore. Në vërtetimet e punësimit, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, pasqyrohen të ardhurat e përfituara, të cilat, gjithashtu, konfirmohen nga këto të fundit. Në analizën financiare të kryer për pasurinë e paluajtshme, janë përfshirë vetëm të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2004 deri në momentin e investimit. Në pyetësin nr. 1, datë 15.5.2020, subjekti ka deklaruar se kursimet e bashkëshortit kanë qenë në vlerën 1.000.000 lekë.

Në analizën e kryer nga Komisioni, në termin kurse janë përfshirë vetëm të ardhurat e siguruar gjatë vitit 2004, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar kurse *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003.

1.7.ii Në lidhje me marrjen e kredisë bankare

Gjatë hetimit të Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë marrë një kredi në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë (UBA). Kredia konfirmohet me kontratën⁸ e kredisë nr. ***, datë 22.1.2005. Sipas kontratës, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë përfituar kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi.

Sipas kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 22.1.2005, rezultoi se kolateral për këtë kredi është vënë pikërisht apartamenti me sip. 75 m², për të cilën po merrej edhe kredia.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar⁹, rezultoi se kredia është disbursuar në datën 8.2.2005 dhe bashkëshorti i subjektit, z. P.P., e tërheq këtë kredi në datën 10.2.2005, në shumën 1.975.000 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni konstatoi se kredia është përfituar rreth dy muaj pas formalizimit të kontratës së shitjes së kësaj pasurie, e cila datonte më 24.11.2004 dhe, për pasojë, nuk mund të ketë shërbyer si burim në datën e nënshkrimit të kontratës.

1.8 Në lidhje me pagesat e kryera për këtë pasuri

1.8.1 Subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 1, datë 15.5.2020, ka deklaruar se: *“Kjo banesë është blerë fillimisht nga një hua monetare nga të afërmit tanë dhe nga kursimet e bashkëshortit tim, në vlerën rreth 1.000.000 (një milion) lekë. Bashkëshorti im ka ushtruar detyrën e prokurorit që nga data 1.10.2002 – 24.11.2004, kur u ble banesa, kishte mbi 2 vite pune... më parë, që nga koha që ka filluar Shkollën e Magjistraturës është trajtuar me gjysmën e pagës së prokurorit, çdo muaj. Bazuar në këtë fakt në kohën e blerjes së banesës në qytetin e Shkodrës, në nëntor të vitit 2004, bashkëshorti kishte të kursyer shumën prej 1.000.000 lekësh, të cilën ia shtuam shumës së marrë hua nga të afërmit, me të cilën u ble paraprakisht kjo banesë. Në lidhje me këtë kursim të bashkëshortit, shpjgoj se nga ana e tij nuk është evidentuar në deklaratat periodike dhe *Vetting*, për shkak të padijenisë dhe gabimit njerëzor në plotësimin e deklaratave. Këtë pretendim e mbështesim në faktin që po të shihen deklaratimet e viteve 2003 (bërë në vitin 2004) dhe 2004 (bërë në vitin 2005,) evidentohet qartazi gabime në plotësimin e këtyre deklaratave, të tilla si deklarim i pagës mujore bruto si të ardhura për deklarimin e*

⁸Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹Shkresë ref. *** prot., datë 8.5.2020, nga UBA.

vitet 2003, deklarimi i kredisë së marrë në vitin 2005 si detyrim i vitit 2004, deklarimin e pagës sime si prokurore për vitin 2004, në një kohë që thuhet gjatë gjithë këtij viti unë kam jetuar në familjen time të origjinës, etj. Theksoj se këto gabime kanë ardhur nga padijenja për shkak se ishim të rinj në detyrë dhe ishte një procedurë e re që aplikohet për herë të parë në prokurori. Ky kursim, ndër vite, në shumën 1.000.000 lekë, mund të nxirret fare mirë nga analiza financiare e viteve 2002-2003-2004 të bashkëshortit tim (pagat e tij gjatë këtyre viteve). Në vijim për shlyerjen e detyrimit të huas, marrë të afërmve të mi, kemi marrë një kredi bankare pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, në vlerën 2.000.000 leke. Në datën 23.11.2004, unë dhe bashkëshorti kemi marrë hua shumën prej 1.500.000 lekë, hallës sime L. Th. dhe bashkëshortit të saj Xh. (Xh.) Th., për efekt të blerjes së banesës sime në qytetin e Shkodrës. Në lidhje me këtë hua, e cila është formatizuar me një dokument noterial kontratë huadhënie nr. *** rep., datë 23.11.2004, ku është përdorur një ditë më vonë në datën 24.11.2004, për të blerë apartamentin, dua të theksoj se është marrë përkohësisht, derisa banka të lëvronte kredinë, në kushtet që nuk kishim kolateral për të lënë si garanci, për marrjen e kredisë...kjo hua pavarësisht se është marrë për një vit është shlyer nga ana jone pas rreth 3 muajsh nga momenti i marrjes së saj, menjëherë sapo na është lëvruar kredia nga banka. Në lidhje me këtë hua ju sqaroj se ajo nuk është deklaruar asnjëherë nga ana ime dhe e bashkëshortit tim si ish-prokurore, meqenëse nuk e kemi konsideruar asnjëherë si burim të blerjes së banesës sonë, për shkak të kohës shumë të shkurtër të mbajtjes dhe qëllimit për të cilin ne e kishim marrë (vetëm për të garantuar kolateralin për kredinë me të cilën do të paguhej banesa nëpërmjet pronësisë së objektit). Duke qenë se në banesën e kemi paguar me kredi, që ka filluar nga viti 2005 e deri në vitin 2007 dhe kemi deklaruar gjithnjë kredinë, si burim financimi për blerjen e shtëpisë, kjo ka qenë arsyeja që nuk e kemi deklaruar këtë hua. Aq më tepër që meqenëse huaja ishte për një periudhë të shkurtër 3-mujore dhe në fund të vitit 2005 nuk e kishim këtë detyrim, ne nuk e kemi deklaruar. Gjithashtu, kjo ka ardhur edhe si rezultat i gabimit njerëzor në plotësimin e deklaratave të pasurisë, padijenisë sonë në plotësimin e deklaratave të pasurisë, si persona që sapo kishin filluar punë dhe duke qenë se edhe procesi i deklarimit të pasurisë sapo kishte filluar, por kurrsesi nuk është rrjedhojë e ndonjë shkakut për fshehjen e burimit të financimit të kësaj banese. Këtë fakt e provojmë edhe nga mënyra sesi ne kemi plotësuar deklaratat tona të pasurisë në vitin 2005 për vitin 2004, ku është bërë deklarimi i pasurisë jo deri më 31.12.2004, por deri më 31.3.2005, ku në të vërtetë kjo datë është afati i dorëzimit dhe jo i deklarimit. Në deklaratën e pasurisë për vitin 2004 për shkak të këtij gabimi njerëzor është përfshirë edhe kontrata e kredisë me Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, e cila është lëvruar në vitin 2005”.

Për të vërtetuar saktësinë e këtij deklarimi të huas, subjekti ka depozituar kopje të deklaratës noteriale të mbajtur në vitin 2004, për të cilën është shprehur se: “Realisht në atë kohë e mbajtëm me qëllimin e vetëm që t’i jepnim siguri huadhënësve/hallës dhe bashkëshortit të saj, për kthimin e shumes) dhe deklaratën e huadhënësve për kthimin e kësaj shumë të mbajtur me datën 28.12.2019”. Gjithashtu, subjekti është shprehur: “Për të vërtetuar saktësinë e këtij deklarimi deklarata noteriale e vitit 2004 është e shënuar në regjistrin noterial të noteres përpara së cilës është mbajtur, të vitit 2004 dhe një kopje e kësaj deklarate disponohet edhe nga palët dhe noterja. Kjo gjë pasqyron më së miri faktin se ky veprim ka ndodhur në atë kohë (pra, në vitin 2004), pavarësisht se nga ana jone gabimisht nuk është evidentuar”.

Në vijim, subjekti ka deklaruar se pagesa për blerjen e banesës është kryer cash te shitësi.

1.8.2 Në mbështetje të deklarimit të kryer, subjekti ka depozituar kontratën e huadhënies, datë 23.11.2004, lidhur midis huadhënësve Xh. dhe L. Th. dhe huamarrësve Ajola dhe P. P. .

1.8.3 Gjatë hetimit nga Komisioni rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti¹⁰ nuk e kanë deklaruar këtë hua si burim krijimi për pasurinë në deklaratën për *Vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit 2004, si detyrim ligjor, apo në ndonjë prej deklaratave periodike pasuese.

- Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk e kanë deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2005 shlyerjen e kësaj huaje.

1.9 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 1.500.000 lekë dhënë hua nga shtetasi Xh. (Xh.) Th. dhe L. Th.

1.9.1 Subjekti në pyetësin nr. 1, datë 15.5.2020, ka deklaruar se: “... halla më ka thënë se një pjesë të parave që më është dhënë hua i ka pasur në banesë dhe pjesa më e madhe është tërhequr nga ana e saj dhe bashkëshortit nga banka, ku ata i kishin depozituar më parë, ku për këtë fakt iu vëmë në dispozicion lëvizjet bankare të vitit 2004 (*statement of account*) të kësaj familje, ku koha e tërheqjes përkon me kohën që kjo hua më është dhënë mua me akt noterial të shkruar. Theksoj se halla ime dhe bashkëshorti i saj Xh. (Xh.) Th. kanë pasur, ndër vite, të ardhura monetare si rrjedhojë e punës së aktivitetit të shitje fruta-perimeve të bashkëshortit të hallës, fakt ky që pasqyrohet edhe në depozitat bankare të bëra nga kjo familje, ndër vite, të cilat do t’jua dërgoj bashkëlidhur me këtë pyetësor (*statement of account*). Theksoj se edhe aktualisht bashkëshorti i hallës sime vijon të ushtrojë të njëjtin aktivitet të shitjes së fruta-perimeve në tregun e qytetit të Shkodrës dhe veç kësaj në dijeninë time aktualisht kanë një aktivitet të shitjes së rrobave, në një prej dyqaneve të këtij qyteti (me emrin ‘E.’). Nga halla dhe bashkëshorti i saj më është thënë se një pjesë e të ardhurave të tyre është edhe nga shitja e pasurive të tyre të paluajtshme (tokë arë, e fituar prej tyre në bazë të ligjit nr. 7501, si banues në fshat)”.

1.9.2 Komisioni i ka kërkuar¹¹ subjektit të depozitojë dokumentacion provues për burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, e cila përgjigjen ka sqaruar se: “...është rrjedhojë e shfrytëzimit të pasurive të paluajtshme (tokë arë) të huadhënësve, të fituara në pronësi në bazë të ligjit nr. 7501 ‘Për tokën’, si në drejtim të shfrytëzimit të këtyre tokave me kultivimin e tyre, ashtu dhe në drejtim të shitjes së tyre”. Gjithashtu, subjekti deklaroi se: “Burim i konsiderueshëm i të ardhurave në familjen e hallës (burimi më i rëndësishëm i të ardhurave) ka qenë veprimtaria e bashkëshortit të hallës në shitjen e fruta-perimeve me shumicë e pakicë.....Ndërkohë rezultoi të ketë në bashkëpronësi me vëllezërit e tij edhe pasuri të tjera, tokë arë, ndodhur në të njëjtën zonë kadastrave, të cilat janë shfrytëzuar prej tij për prodhim produktesh bujqësore dhe shitjen e tyre.”

1.9.3 Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës për të provuar burimin e të ardhurave të huadhënësve si, kontratë shitje pasurie e vitit 1999, kartelë pasurie të paluajtshme për të evidentuar tjetërsimet e pasurive në vitin 2001, certifikatë regjistrimi në organin tatimor për ushtrimin e aktivitetit nga shtetasi Xh. Th., si biznes i vogël, e cila daton prej vitit 2000, apo llogari bankare për të evidentuar depozitat, si dhe certifikatën e trungut familjar të bashkëshortit të hallës Xh. (Xh.) Th., për të provuar lidhjet e gjinisë me bashkëpronarët e tjerë, etj.

1.9.4 Komisioni, përveç analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, mbajti korrespondencë edhe me institucionet publike.

1.9.5 Nga dokumentacioni¹² i administruar rezultoi që shtetasi Xh. (Xh.) Th.:

- në datën 23.7.1999 së bashku me familjarët e tjerë kanë shitur pasuri të paluajtshme në vlerën 500.000 lekë;

¹⁰Për shkak se ka qenë subjekt deklarues me funksionin prokuror, ka deklaruar për periudhën 2003 – 2014.

¹¹Me pyetësin nr. 2, datë 15.6.2021.

¹²Dokumentacion mbështetës i depozituar nga subjekti në pyetësin nr. 2 datë 15.6.2021.

- në fund të vitit 2001 ka shitur pasurinë e paluajtshme me sip. 1669 m², në vlerën 1.751.400 lekë; si dhe

- ka pasur depozitë në BKT, llogari në emër të L. Th., e krijuar në prill të vitit 2004 nga e cila është tërhequr shuma 500.000 lekë në datën 19.11.2004, pak ditë përpara hartimit të kontratës së huas.

1.9.6 DPSHTRr-ja¹³ ka konfirmuar se shtetasi Xh. C. Th. ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***. Nga dokumentacioni mbështetës provohet se ky automjet është furgon dhe është blerë në datën 21.2.2000, në vlerën 1.500.000 lekë. Konfirmohet se është i njëjti automjet, i cili është regjistruar edhe në degën e tatim taksave të rrethit, si vend i ushtrimit të aktivitetit, autodyqan.

1.9.7 Komisioni për një hetim më të thelluar mbajti korrespondencë me Bashkinë Shkodër, si dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, lidhur me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit nga shtetasi Xh.Th. . Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër¹⁴ ka informuar se nuk disponohen të dhëna dhe dokumentacion për shtetasin Xh. C. Th., me kod fiskal ***, ndërsa Bashkia Shkodër¹⁵ ka informuar se shtetasi Xh.C.Th. nuk është i regjistruar si biznes në regjistrat e taksapaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në këtë bashki.

1.9.8 Komisioni nisur nga fakti, se: (i) kjo hua nuk rezultoi e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit 2004; (ii) deri në këtë fazë të hetimit nuk u provuan të ardhura të ligjshme të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit privat nga huadhënësi; (iii) mbeti e paqartë, nëse shuma e përfituar në vitin 2001 nga tjetërsimi i pasurisë në vlerën 1.751.400 lekë ka shërbyer për të krijuar depozitën bankare nga e cila është tërhequr shuma 500.000 lekë përpara dhënies së huas, apo ka shërbyer për dhënien e kësaj të fundit; (iv) në analizën financiare (deri aktualisht) për krijimin e kësaj pasurie nuk mori në konsideratë huan prej 1.500.000 lekësh. Analiza u krye vetëm me kursimet e realizuara nga subjekti dhe bashkëshorti, nga 1 janar – 24 nëntor 2004, kur është kryer investimi, pasi kredia daton pas lidhjes së kontratës.

1.9.9 Gjithashtu, Komisioni kreu edhe analizën financiare vjetore, duke përfshirë të ardhurat e përfituara gjatë vitit kalendarik nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, investimin e kryer në blerjen e apartamentit, shpenzimet e jetesës, si dhe shpenzimet lidhur me arredimin e apartamentit. Nga analiza financiare, Komisioni konstatoi se viti 2004 rezultoi në balancë negative në shumën 1.327.330 lekë, nga të cilat 1.054.115 lekë i përkasin pamundësisë së subjektit për të investuar në blerjen e apartamentit deri në datën 24.11.2004, ndërsa diferenca (273.215 lekë) pas kësaj date deri në fund të vitit 2004, i përket pamundësisë financiare për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe arredimit të apartamentit.

1.9.10 Pas përllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni, u konstatua se dukej se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.054.115 lekë, për të investuar në pasurinë apartament, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2004, burimin e krijimit të kësaj pasurie; (iii) nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 273.215 lekë, për të të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe arredimin e apartamentit; (iv) kishte mospërputhje në burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* deklaroi *paratë e kursyera nga të ardhurat dhe kredi*, ndërsa gjatë hetimit deklaroi *kursime në shumën 1.000.000 lekë të bashkëshortit dhe hua në shumën 1.500.000 lekë*; (v) nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2004

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2021.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2021.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 3.8.2021.

huan e marrë, detyrimin e mbetur, si dhe shlyerjen e saj në vitin 2005 dhe, për pasojë, iu kalua barrë e provës¹⁶ për të dhënë argumentet në lidhje me konstatimet e bëra nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

1.9.11 Subjekti në parashtrimet e saj¹⁷, lidhur me konstatimet e Komisionit, ndër të tjera, ka paraqitur disa pretendime:

1.9.11.i Sa i përket pamundësisë financiare në shumën 1.054.115 lekë, për të investuar në pasurinë apartament, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, subjekti, në referim edhe të përgjigjeve të dhëna me pyetësorin nr. 1, datë 15.5.2020, ka shpjeguar se shuma prej 2.450.000 lekësh, shpenzuar për blerjen e apartamentit, është krijuar nga të ardhurat e kursyera deri në datën e blerjes së kësaj pasurie (më 24.11.2004), si dhe huaja e marrë në datën 23.11.2004 huadhënësve Xh.(Xh.) Th. dhe L. Th. (halla e saj). Subjekti ka sqaruar se *huaja është formalizuar në atë kohë me aktin kontratë huadhënie nr. *** rep., datë 23.11.2004, lidhur përpara noterës L. H., një ditë përpara blerjes së banesës*. Subjekti ka pretenduar se huaja është marrë pasi ndodheshin në kushtet e pamundësisë për të blerë një apartament vetëm me kursime dhe ndërkohë bankat nuk mund të jepnin kredi pa lënë një pasuri të paluajtshme, si garanci për bankën. Në vijim ka sqaruar se *huaja është marrë në datën 23.11.2004 dhe më 24.11.2004 (një ditë më pas) është lidhur kontrata e blerjes së apartamentit. Pas regjistrimit të kësaj prone, menjëherë kemi aplikuar për marrjen e kredisë bankare pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, kredi e cila na është lëvruar në shkurt të vitit 2005. Qëllimi i marrjes së kësaj kredie, siç është pasqyruar edhe në kërkesën për marrjen e saj bankës, ishte pikërisht blerja e apartamentit, pasuri e cila në të njëjtën kohë u la garanci për shlyerjen e kredisë. Sapo kemi marrë kredinë e lëvruar nga banka i kemi kthyer menjëherë huadhënësve L. dhe Xh. Th. shumën e marrë hua. Sa më sipër, subjekti ka pretenduar se konstatimi i Komisionit ka ardhur si rrjedhojë e mospërfshirjes të të gjitha të ardhurave të vitit 2004, në analizën financiare. Konkretisht ka pretenduar se në analizën financiare të vitit 2004 duhet të përfshihej huaja e marrë në shumën 1.500.000 lekë, pasi edhe pse nuk është deklaruar prej saj dhe bashkëshortit, ekziston një akt noterial, me fuqi të plotë provuese, i regjistruar në regjistrin noterial të këtij viti. Subjekti ka ritheksuar që në analizën financiare të vitit 2004 të përfshihej, si e ardhur edhe huaja në vlerën 1.500.000 lekë, pasi shumës së të ardhurave të vitit 2004, po t'i shtojmë edhe huan në shumën 1.500.000 lekë, rezulton një bilanc pozitiv prej 445,885 lekësh, deri në datën e blerjes së banesës, i cili mbulon edhe blerjen e pasurisë apartament, por edhe përballimin e shpenzimeve familjare deri në këtë datë. Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihen edhe kursimet e bashkëshortit në vitin 2003, duke pranuar se konstatimi që nga bashkëshorti, në DPV e vitit 2004, nuk janë deklaruar kursime, është i vërtetë, por kjo ka ardhur si pasojë e mosnjohjes korrekte të ligjit për deklarimin e pasurisë. Sa i përket vlerës së kursimeve subjekti ka pretenduar si vijon: “Në lidhje me vlerën e kursimeve për vitin 2003, duke u bazuar në analizën financiare të bërë nga ekspertët e Komisionit, rezulton se bashkëshorti im ka të ardhura në vlerën 641.270 lekë. Duke zbritur shpenzimet për jetesë të bashkëshortit, sipas ILDKPKI-së në vlerën 93.864 lekë (për një person të vetëm) rezulton se vlera e kursimeve për këtë vit është në shumën 547.406 lekë”. Subjekti ka bërë referencë vendimin nr. 327, datë 23.12.2020, të Komisionit, ku në interpretimin e saj, mosdeklarimi i kursimeve nga subjekti nuk u konsiderua penalizues, por pakujdesi në plotësimin e deklaratës, duke kërkuar që Komisioni të vlerësojë situatën e saj në të njëjtat rrethana me subjektin e sipërcituar.*

1.9.11.ii. Sa i përket mosdeklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2004, subjekti ka kundërshtuar këtë konstatim të Komisionit, duke cituar

¹⁶Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁷Datë 15.10.2021.

shprehimisht: “Në DPV-në e vitit 2004 në zërin ‘detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë’ nga ana jonë është deklaruar si burim i krijimit të pasurisë apartament, kredia bankare. Theksoj se në DPV-në e vitit 2004, që mbulon periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004, unë nuk kam pasur asnjë detyrim të deklaroja kredinë që e kam marrë në vitin 2005. Megjithatë siç rezultoj nga DPV-ja e vitit 2004 kam deklaruar kredinë që kam marrë në vitin 2005 dhe që do të duhet ta deklaroja në DPV-në e vitit 2005”. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur qëllim të fshehtë huan e marrë në datën 23.11.2004, hallës dhe bashkëshortit të saj, pasi kjo hua ishte marrë me akt noterial të kësaj date dhe ky veprim juridik, si i tillë, nuk mund të fshehej. Në mënyrë të përmbledhur subjekti ka deklaruar se mosdeklarimi i huas marrë hallës dhe bashkëshortit të saj më 3.11.2004, në DPV-në e vitit 2004 ka ardhur për shkak të disa rrethanave: “Mosnjohjes së drejtë të ligjit për deklarimin e pasurisë dhe mënyrës formale të plotësimit të formularit të pasurisë; mosdhënies rëndësi maksimale, në atë kohë këtij fakti, në kushtet që në çmuarjen tonë kishim sqaruar mënyrën e blerjes së apartamentit; kohës së shkurtër të mbajtjes së kësaj huaje dhe qëllimit për të cilin ne e kishim marrë huan, atë të fitimit të pronësisë së objektit (apartamentit), me qëllim për ta lënë si garanci hipotekore lidhur me kredinë bankare që do të merrej; mosdeklarimi në vijimësi i kësaj huaje ka ardhur edhe si rrjedhojë e faktit se kjo problematikë nuk na u shtrua asnjëherë nga ILDKPKI¹⁸, etj.”.

1.9.11.iii. Sa i përket konstatimit mbi pamundësinë financiare në shumën 273.215 lekë, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe arredimin e apartamentit, subjekti është shprehur se vlejné të njëjtat argumente të paraqitura në pikat 1.9.11. (i) dhe 1.9.11 (ii), më sipër duke deklaruar: “... pas përfshirjes në analizë financiare të huas, marrë nga halla dhe kursimet e bashkëshortit për vitin 2003, deri në datën 24.11.2004, kur është blerë apartamenti, rezultojnë një bilanc pozitiv në shumën 993.291 lekë. Duke llogaritur shpenzimet familjare, arredim etj. nga kjo datë deri në datën 31.12.2004, në shumën e nxjerrë nga ana Juaj 273,215 lekë, atëherë në datën 31.12.2004 ne rezultojmë me një bilanc pozitiv, në vlerën 720.076 lekë¹⁹...”.

1.9.11.iv. Sa i përket, konstatimit tjetër të Komisionit, lidhur me mospërputhjen në burimin e krijimit të kësaj pasurie, midis deklaratës Vetting, ku janë deklaruar si burime “paratë e kursyera nga të ardhurat dhe kredi” dhe deklarimeve gjatë hetimit “kursime në shumën 1.000.000 lekë të bashkëshortit dhe hua në shumën 1.500.000 lekë”, në vijim të arsyeve lidhur me mosdeklarimin e huas, të evidentuara nga subjekti në pikën 1.9.11 (ii) më sipër, ky i fundit ka sqaruar se: “Blerja e banesës në qytetin e Shkodrës, është bërë fillimisht me kursimet dhe huan marrë hallës e bashkëshortit, veprime të cilat janë kryer në funksion të marrjes së kredisë bankare, për të cilën unë kam paguar për tre vjet. Nëse kredia nuk do të ishte burim i krijimit të kësaj pasurie, atëherë nuk do të kisha asnjë arsye për ta marrë këtë kredi, e cila ka shërbyer pjesërisht (në shumën 1.500.000 lekë) për pagimin e huas në vitin 2005. Pra, nëse me kredinë bankare nuk do të ishte shlyer huaja e marrë në vitin 2004, atëherë në fund të vitit 2005 ne duhet të kishim deklaruar kursime monetare, gjë që nuk është bërë nga ana jonë, pasi me kredinë që morëm shlyem huan dhe pjesën e mbetur e përdorëm për nevojat tona”.

Në lidhje me kursimet e bashkëshortit në shumën 1.000.000 lekë, të cilat nuk janë deklaruar si gjendje cash në DPV-në për vitin 2003, subjekti pohon se ky është një fakt i vërtetë, por kjo ka ardhur si pasojë e mosnjohjes korrekt të ligjit, për deklarimin e pasurisë dhe mënyrës formale të plotësimit të formularit të pasurisë. Subjekti ka sqaruar se ishte viti i parë i deklarimit të pasurisë dhe se rëndësia e këtij fakti ka konsistuar vetëm në dorëzimin e deklaratës brenda afatit ligjor, për të shmangur penalizimet e karakterit administrativ apo penal. Për ta bërë të besueshëm këtë fakt, subjekti ka vijuar të shpjegojë se prej tyre janë bërë edhe gabime të tjera

¹⁸“Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 10.3.2016, mbajtur nga ILDKPKI-ja, depozituar nga subjekti me parashtrimet.

¹⁹Për më shumë referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit.

në plotësimin e deklaratave. Nën këto arsye, subjekti pretendon se kjo shumë duhet marrë në konsideratë të përlogaritjet financiare.

1.9.11.v. Sa i përket mosdeklarimit në deklaratën periodike të vitit 2004 të huas së marrë, detyrimit të mbetur, si dhe shlyerjes së saj në vitin 2005, subjekti ka deklaruar se konstatimi është i drejtë dhe prej saj dhe bashkëshortit është bërë gabim në mosdeklarimin e huas dhe, ndër të tjera, ka pretenduar se mosformalizimi i kthimit të huas ka ndodhur për shkak të marrëdhënieve të afërta familjare, por për të provuar kthimin e shumës është nënshkruar deklarata noteriale e datës 27.12.2019, *me autentifikim nënshkrimi, në prani të noterit, me nr. *** rep., datë 28.12.2019*. Gjithashtu, subjekti ka theksuar se huaja ka shërbyer si mjet formal për blerjen e banesës, por kredia bankare ka qenë burimi kryesor për blerjen e banesës në aspektin substancial. Në konkluzion, subjekti ka pranuar se duke qenë se huaja ka qenë pjesë e rrethanave të blerjes së banesës, duhej të ishte deklaruar.

1.9.12 Në vijim, subjekti, për sa i përket burimit të krijimit të vlerës monetare të dhënë hua nga halla dhe bashkëshorti i saj, ka sqaruar se familja e hallës, sipas thënieve të hallës dhe bashkëshortit, ka realizuar të ardhura nga: (i) ushtrimi i aktivitetit tregtar nga bashkëshorti i saj; (ii) shfrytëzimi bujqësor i tokës; si dhe (iii) shitja e tokës së fituar në bazë të ligjit nr. 7501.

Lidhur me aktivitetin tregtar të shtetasit Xh. (Xh.) Th. (bashkëshorti i hallës), subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve: (i) kërkesën e datës 14.10.2021, depozituar në DRT Shkodër, me nr. *** prot., datë 14.10.2021 (nga burri i hallës); (ii) përgjigjen e DRT-së Shkodër, nr. *** prot., datë 14.10.2021, shoqëruar me certifikatën e regjistrimit në organin tatimor, me numër serial***dhe situatën e printuar nga sistemi C@ts; si dhe (iii) fotokopje të shkresës nr. *** prot., datë 13.8.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nga bashkëshorti i hallës i është thënë se është e pamundur për të siguruar dokumentacion për ushtrimin e aktivitetit, para vitit 2005, *pasi sipas tij, nga punonjësit e DRT-së Shkodër, i është thënë gojarisht, por nuk kanë pranuar që të japin akt shkresor, se duke qenë se deri në vitin 2005 dokumentacioni është mbajtur në mënyrë manuale (me dorë) dhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar (15 vjet) shumica e dokumenteve janë asgjësuar, pasi nuk kanë qenë në gjendje të mirë fizike*.

Në mbështetje të argumenteve lidhur me burimin e të ardhurave të huadhënësit, subjekti ka referuar për analogji edhe vendime të Komisionit²⁰. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar²¹ se si burim i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit ka qenë shitja e pasurive të paluajtshme nga ana e burrit të hallës.

Subjekti ka pretenduar se bashkëshorti i hallës ka në pronësi disa prona të paluajtshme (AMTP me numër akti ***, sipërfaqe toke prej 9000 m², i vetëm, ku nga këto 8700 m² janë tokë arë dhe 300 m² truall), bashkëpronësi me vëllezërit e tij edhe pasuri të tjera, tokë arë, ndodhur në të njëjtën zonë kadastrale, të cilat janë shfrytëzuar prej tij për prodhim produktesh bujqësore dhe shitjen e tyre. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar dokumentacionin e ASHK-së Shkodër, si dhe certifikatën e trungut familjar të bashkëshortit të hallës Xh. (Xh.) Th. . Subjekti ka pretenduar se një pjesë e këtyre pasurive është tjetërsuar prej tyre, duke krijuar të ardhura monetare *cash*, ku nga dokumentacioni që i është dhënë ka evidentuar disa shitblerje, nga të cilat halla dhe bashkëshorti i saj kanë marrë të ardhura monetare. Më konkretisht, subjekti ka depozituar: (i) *kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 23.7.1999, ku halla, bashkëshorti i saj dhe familjarë të bashkëshortit kanë shitur një tokë në bashkëpronësi në vlerën 500.000 lekë dhe, konkretisht, është shitur pasuria me numër ***, me sip. 1500 m², ndodhur në z. k. ***, D. Shkodër; si dhe (ii) kartelën e pasurisë së paluajtshme për tjetërsimin*

²⁰Vendimet nr. 96, datë 9.1.2019 dhe nr. 31, datë 4.7.2018.

²¹Pretendim i ngritur për herë të parë në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 15.5.2020.

në datën 27.12.2001 të pasurisë nr. ***, ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, D. Shkodër, me sip. 1668 m² nga shtetasi Xh. C. Th. te shtetasi A.B.P., për shumën 1.751.400 lekë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.10 Trupi gjykues në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, por dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

1.10.1 Lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaramit të subjektit për burimin e ligjshëm të pasurisë apartament me sip. 75 m², fituar sipas kontratës së blerjes nr. ***, datë 24.11.2004, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, në deklaratën periodike të vitit 2004, si dhe përgjatë viteve, sikurse ka pretenduar se si burim krijimi ka shërbyer, huaja e marrë nga halla dhe bashkëshorti i saj në vitin 2004, si dhe kursimet e bashkëshortit të saj/subjektit të rivlerësimit, në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2003.

1.10.2 Nga analizimi i deklaramive të subjektit, trupi gjykues ka konstatuar se burimi i deklaruar përgjatë hetimit administrativ për marrjen e huas në shumën 1.500.000 lekë, në vitin 2004, për shlyerjen e saj në vitin 2005, por edhe i disponimit të shumës 1.000.000 lekë, e kursyer nga bashkëshorti në vitin 2003, nuk gjendet i deklaruar në deklaramet periodike përkatëse dhe as në deklaratën *Vetting*.

1.10.3 Trupi gjykues, në referim të pikës 2 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku është parashikuar shprehimisht detyrimi i subjektit të rivlerësimit për dorëzimin e një deklarate të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, konstatoi se ky detyrim nuk është përmbushur prej tij dhe po ashtu konstatoi se subjekti nuk arriti të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave (arsyetim ky i pasqyruar në vijim të kësaj vendimmarrje), sikurse është parashikuar në pikën 3 të po këtij neni.

1.10.4 Trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i burimit real të kësaj pasurie, pra, i huas dhe kursimit në vlerën 1.000.000, në kohë reale dhe kryesisht në deklaratën *Vetting*, është veprim i kryer në kundërshtim me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 7 të Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Më konkretisht, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin. Ky përcaktim kushtetues është shtjelluar, më tej, në nenin 32 “deklarimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaramive për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Ndërsa, pika 7, e Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, parashikon se për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, ...etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

1.10.5 Subjekti i rivlerësimit gjatë gjithë periudhës së deklaramit (DPV-ve), por edhe në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar burim tjetër të kësaj pasurie, përveç kursimeve dhe kredisë bankare²². Subjekti ka ndryshuar qëndrimin lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në pyetësorin nr. 1, datë 15.5.2020, duke deklaruar për herë të parë se: “Kjo banesë është blerë

²²Kredia konfirmohet me kontratën e kredisë nr. ***, datë 22.1.2005. Sipas kontratës, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar kredinë në shumën 2.000.000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi.

fillimisht nga një hua monetare nga të afërmit tanë²³ dhe nga kursimet e bashkëshortit tim, në vlerën rreth 1.000.000 lekë”.

1.10.6 Në vijim, duke qëndruar dhe arsyetuar, lidhur me mosdeklarimin e huas në kohë reale në DPV-në e vitit 2004, si burimi kryesor i krijimit të kësaj pasurie, sa i përket arsyeve dhe rrethanave, të pretenduara nga subjekti, të cilat kanë ndikuar në mosdeklarimin e huas marrë hallës dhe bashkëshortit të saj, më 23.11.2004, trupi gjykues vlerëson se ato janë të pabazuara, pasi: (a) mosnjohja e ligjit, sidomos nga ushtruesi i kësaj detyre që përfaqëson zbatimin e ligjit dhe doktrinën juridike, nuk është arsye për ta përjashtuar nga përgjegjësia; (b) fakti që subjekti marrëdhënien e huas e ka formalizuar nëpërmjet lidhjes së një kontrate huadhënie (me akt noterial), duke pranuar që me huan e marrë është bërë pagesa e apartamentit, provon faktin së huaja ka qenë burimi real për krijimin e kësaj pasurie dhe jo kredia bankare që është marrë rreth dy muaj më vonë nga momenti i blerjes së apartamentit dhe, për këtë shkak, duhet të ishte deklaruar qartësisht në kohë reale dhe në deklaratën *Vetting*; (c) koha e shkurtër e mbajtjes së kësaj huaje, qëllimi për fitimin e pronësisë së objektit (apartamentit), për ta lënë si garanci hipotekore, lidhur me kredinë bankare që do të merrej, nuk mund të konsiderohet si argument bindës ligjor për mosdeklarimin e burimit real të kësaj pasurie. Ligji nuk rezulton të ketë bërë diferencim lidhur me mosdeklarimin për shkak të llojit të huave, afatgjata apo afatshkurtra, si burim krijimi pasurish²⁴; (ç) fakti që ILDKPK-ja nuk është shprehur dhe nuk e ka konstatuar si problematikë, nuk e justifikon mosdeklarimin e huas, pasi hetimi nga ana e Komisionit është një proces i pavarur. Trupi gjykues, vlerëson se faktet e sipërcituara marrin vlerë për sa kohë që nga hetimi administrativ rezultoi se këto mosdeklarime nuk janë shëruar në deklaratat periodike vijuese dhe specifikisht në deklaratën *Vetting*, ku ligja e kërkonte në mënyrë detyruese.

1.10.7 Nën konstatimet e lartpërmendura, trupi gjykues çmon se mbetet i pakontestueshëm fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë burimin për krijimin e pasurisë në deklaratën *Vetting*, çka e vendos atë në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm.

1.11. Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të huas, në shumën 1.500.000 lekë, trupi gjykues arsyeton si vijon:

1.11.1 Komisionit i rezultoi se subjekti gjendej në balancë negative, për të investuar në pasurinë apartament, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si rezultat i mosprovueshmërisë së burimit të ligjshëm të huas së marrë nga shtetasit L. dhe Xh. Th. .

1.11.2 Trupi gjykues në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, dokumentacionit të administruar, parashtrimeve të subjektit, për të përfshirë në analizën financiare huan e marrë për blerjen e kësaj pasurie në shumën 1.500.000 lekë nga të afërmit e saj, fillimisht konstatoi se huaja ishte ligjëruar nëpërmjet kontratës së huadhënies nr. *** rep., datë 23.11.2004, përpara noterit publik L.H., pra, një ditë përpara blerjes së banesës, por edhe kjo marrëdhënie kontraktore nuk është deklaruar nga subjekti në kohë reale, pra, në DPV-në e vitit 2004, po ashtu, edhe detyrimi i mbetur për shlyerjen e saj as edhe në deklaratën *Vetting*.

1.11.3 Në analizë të deklaratës noteriale, datë 27.12.2019, *me autentifikim nënshkrimi, në prani të noterit, me nr. *** rep., datë 28.12.2019*, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se huadhënësit nën përgjegjësinë e tyre ligjore dhe me vullnet të lirë kanë deklaruar lidhur me vërtetësinë e burimeve të tyre për krijimin e shumës së dhënë hua se ajo përbëhet nga të ardhurat e tyre nga biznesi dhe se këto i kanë pasur përkatësisht në vlerën 1.000.000 lekë në llogarinë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, të cilat i kanë tërhequr dhe se vlerën 500.000 lekë e kanë pasur në banesë, ndërsa subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se

²³Huaja është marrë në datën 23.11.2004, në shumën 1.500.000 lekë, nga bashkëshortët Xh. (Xh.) Th. dhe L. Th. (halla dhe burri i saj).

²⁴Sikurse shprehet vendimi nr. 19, datë 13.7.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

huadhënësit i kanë thënë se si burim kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë.

1.11.4 Në funksion të deklarimeve të huadhënësve, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, ka konstatuar se nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit privat nga huadhënësi, për shkak se informacioni i dërguar nga institucionet tatimore provoi ekzistencën e dokumentacionin certifikues të ushtrimit të biznesit për huadhënësit, por jo qarkullim apo fitim të ardhurash. Trupi gjykues nuk mohon ushtrimin apo kryerjen e aktivitetit privat nga huadhënësit, krijimin dhe fitimin e të ardhurave prej aktivitetit, por në raport me kërkesat ligjore për provueshmërinë e burimit të ligjshëm, pretendimet e huadhënësve, për rrjedhojë, edhe të subjektit mbeten vetëm në nivel deklarativ.

1.11.5 Edhe nga verifikimi i transaksioneve bankare rezultoi se nga shuma 1.000.000 lekë, ishin tërhequr vetëm 500.000 lekë dhe jo e gjithë shuma sikurse deklarohet nga huadhënësit në deklaratën noteriale të sipërcituar. Ky konstatim krijon një pamjaftueshmëri në vetvete të provueshmërisë së burimit të krijimit të shumës 1.500.000 lekë, për shkak se në një logjikë të drejtë matematikore shuma e tërhequr prej 500.000 lekësh, së bashku me atë të pretenduar nga huadhënësit *se ishte në banesë*, në tërësi nuk përbëjnë shumën e dhënë hua.

1.11.6 Po ashtu, trupi gjykues në analizën financiare, lidhur me ligjshmërinë e shumës së dhënë hua, nuk vlerësoi kryerjen e përlogaritjeve përpara vitit 2000, por vetëm pas tij, për shkak se në vitin 2000, sikurse është cituar më sipër, rezultoi se huadhënësit kanë shpenzuar një shumë të konsiderueshme për të blerë automjetin e tyre, tip fugon, konkretisht në shumën 1.500.000 lekë, në interes të ushtrimit të biznesit.

1.11.7 Nga ana tjetër, trupi gjykues, për situatën faktike të kësaj çështjeje objekt shqyrtimi, në raport me pretendimin e subjektit se huadhënësit janë shprehur se kjo hua ka pasur si burim krijimi edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë në vitin 2001 në shumën 1.751.400 lekë, vlerë e cila konfirmohet ligjërisht me kartelën përkatëse të pasurisë, çmon se e vetmja shumë që apriori mund të konsiderohet me këtë burim do të ishte shuma prej 500.000 lekësh e deklaruar nga huadhënësit se mbahej prej tyre në banesë në kohën e dhënies së huas. Nga ana tjetër një fakt i pakontestueshëm është transaksioni bankar i kryer pikërisht përpara huadhënies nga huadhënësit, pra, tërheqja e shumës 500.000 lekë dhe jo 1.000.000 lekë, sikurse kanë deklaruar huadhënësit në deklaratën e tyre noteriale. Pra, edhe në variantin e prezantuar nga subjekti, trupi gjykues, vëren se përsëri nuk provohet mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të shumës së dhënë hua. Ky vlerësim, përforcohet, për më tepër, edhe me mospërputhjet e deklaramit të subjektit të rivlerësimit se huadhënësit i kanë thënë se si burim krijimi janë edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë me deklarimin e tyre në deklaratën noteriale se burimi i krijimit të shumës së dhënë hua janë të ardhurat nga biznesi i tyre. Në tërësi, trupi gjykues çmon se faktet e dala nga hetimi dhe analiza e provave të arsyetuara, sa më sipër, janë rrethana që e vendosin subjektin në kushtet që ajo ka dështuar të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të shumës së marrë hua dhe, për pasojë, burimin e krijimit të kësaj pasurie.

1.11.8 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se kishte mospërputhje në burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *paratë e kursyera nga të ardhurat dhe kredi*, ndërsa gjatë hetimit deklaroi *kursime në shumën 1.000.000 lekë të bashkëshortit dhe hua në shumën 1.500.000 lekë*, trupi gjykues analizon si vijon:

1.11.9 Nga hetimi i kryer rezultoi se bashkëshorti i subjektit nuk e ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* në vitin 2003. Në vijim, ky mosveprim i kryer në kundërshtim me ligjin ka vijuar i tillë edhe nga subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2004, kohë kur dhe u krijua pasuria objekt i këtij hetimi administrativ. Rezultoi se subjekti këtë shumë e deklaroi vetëm në pyetësin nr. 1, datë 15.5.2020, si kursim të bashkëshortit. Subjekti ka pretenduar për mosnjohje të ligjit në kohë për të plotësuar siç duhet deklaratat periodike vjetore. Trupi

gjykues çmon se ky pretendim nuk qëndron për shkak të qartësisë dhe konsistencës që ka mbajtur në kohë ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Në këtë drejtim për të mbështetur arsyetimin në analizë ligjore vlen t'i referohemi nenit 5/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Deklarimi para fillimit të detyrës" dhe ish-nenit 6 "deklarimi i parë", të cilët për nga natyra e deklarimit janë të njëjtë, ku përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të deklaruar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit apo në vijim, nga momenti i fillimit të detyrës, të gjitha pasuritë e akumuluar dhe detyrimet financiare të tyre. Referuar germës "d", të pikës 1, të nenit 4, të po të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. Në këto kushte, sikurse vërehet, legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit. Mënyra e deklarimit periodik ka mbetur e pandryshuar, pavarësisht ndryshimeve që mund të kenë pësuar, ndër vite, ligjet e zbatueshme, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave dhe, për rrjedhojë, vlerësohet se subjekti nuk ka qenë asnjëherë në kushtet e paqartësisë ligjore në drejtim të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së këtij deklarimi. Madje legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë edhe në drejtim të pasojave ligjore për subjektet në rast të deklarimit të të dhënave të rreme, për sa kohë në nenin 38 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, parashikohet shprehimisht: "*Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale sipas legjislacionit në fuqi*". Trupi gjykues e vlerëson ekzistencën e këtij parashikimi ligjor si një element përcaktues ndërgjegjësimi të subjekteve deklaruese në drejtim të rëndësisë së procesit dhe deklarimeve të tyre, çka nuk mund të justifikojë pretendimin e subjektit për "*moskuptim të saktë të ligjit*", mbi të gjitha, në rastet kur ligji është i shprehur qartë dhe subjekti deklarues ka nivel të lartë të njohurive ligjore.

1.11.10 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 273.215 lekë, për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe arredimin e apartamentit, trupi gjykues për të mos rënë në përsëritje të argumenteve të pasqyruar më sipër dhe arsyetimit të bërë për ligjshmërinë e shumës së marrë hua, mosprovueshmëria e së cilës diktoi balancë negative dhe kursimet e bashkëshortit në vlerën 1.000.000 lekë, por edhe të faktit se kjo balancë negative e konsideruar pas krijimit të kësaj pasurie në nëntor të vitit 2004 është e pamundur të krijohet vetëm gjatë muajit nëntor – dhjetor 2004. Në të tilla kushte, trupi gjykues mbetet në të njëjtin vlerësim edhe në këtë rast për mospërlllogaritje të mundshme të tjera në analizë financiare dhe që, për pasojë, subjekti nuk mundi të justifikojë këtë shumë si shpenzim për arredimin e pasurisë.

1.11.11 Për sa më sipër, trupi gjykues, pasi analizoi hollësisht të gjithë komponentët e krijimit të kësaj pasurie, mbështetur në parashikimet kushtetuese, ligjore dhe nënligjore, sikurse është përmbajtja e pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe e pikës 7 të Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, çmon se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të dorëzonte deklaratën *Vetting* të shoqëruar me të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë – në këtë rast të apartamentit të banimit në Shkodër – duke deklaruar me vërtetësi burimin e krijimit të tyre, në momentin e krijimit/fitimit të tij²⁵. Kuptimi dhe zbatimi i nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe i dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, kërkojnë që deklarimi i subjektit të rivlerësimit të jetë i besueshëm, i pacenueshëm në vërtetësi dhe në plotësi.

²⁵Një konstatim të ngjashëm ka bërë edhe Kolegji i Posaçëm të Apelit në vendimin nr. 19, datë 13.7.2021.

1.11.12 Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues konkludon se subjekti: (a) nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e ligjshëm të saj në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike të kohës; (b) nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të shumës së huas; si dhe (c) nuk ka deklaruar kursimet/gjendjen *cash* në vlerën 1.000.000 lekë të disponuara nga bashkëshorti dhe, për pasojë, gjendet në balancë negative në shumën 1.327.330 lekë, për të investuar në blerjen e apartamentit për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, si dhe arredimin e apartamentit, sipas parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

1.11.13 Gjithashtu, trupi gjykues çmon se faktet e sipërcituara, të dala nga hetimi, si dhe në analizë të provave të sipërrasyetuara, në raport me: (a) ekzistencën e një kontrate huadhënie të noteruar në kohë reale; (b) qëllimin e marrjes së kredisë, pikërisht për këtë pasuri, por që në fakt një pjesë e konsiderueshme e saj shleu huan e padeklaruar, vlerësohen të tilla që nuk të vendosin në kushtet e aplikimit të *parimit të proporcionalitetit*, pasi pamjaftueshmëria e deklarimit është e lidhur edhe me dështimin e subjektit në provueshmërinë e elementit tjetër, atë të shpjegimit bindshëm të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, që të çmuara në mënyrë kumulative passollën këtë pasojë ligjore, pikërisht aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

1.12 Në lidhje me shlyerjen e huas nga subjekti i rivlerësimit

1.12.1 Subjekti në pyetësin nr. 1, datë 15.5.2020, ka deklaruar se: “...për kthimin e kësaj huaje ne nuk kemi mbajtur në atë kohë akt me shkrim (pasi për shkak të marrëdhënieve familjare nuk mendonim që mund të kishim probleme nga huadhënësit më vonë, të cilët u treguan të gatshëm të na ndihmonin në blerjen e kësaj banese), por kthimi i kësaj shume është formalizuar me shkrim me aktin noterial “deklarate noteriale e datës 27.12.2019”, me autentifikim nënshkrimi në prani të noterit, me nr. *** rep., datë 28.12.2019, të hallës sime, bashkëshortit të saj, unë dhe bashkëshorti im, të cilën ia bashkëngjisim këtij pyetësi. Subjekti ka deklaruar se: “Për shlyerjen e detyrimit të huas, marrë të afërmeve të mi, kemi marrë një kredi bankare pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, në vlerën 2.000.000 lekë”.

1.12.2 Gjatë hetimit, Komisionit i rezultoi se kredia është tërhequr prej bashkëshortit të subjektit në vlerën 1.975.000 lekë në datë 10.2.2005. Gjithashtu, u vërejt se shtetasja L. Th. ka depozituar në llogarinë e saj bankare në BKT shumën 1.500.000 lekë, në datën 29.4.2005. Në këndvështrim edhe të deklaratës noteriale të sipërcituar, por edhe të faktit të moskundërshtive të palëve për këtë shlyerje, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë në trajtimin e kësaj çështje.

1.13 Në lidhje me gjendjen e *konfliktit të interesit*, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, të cilat në përgjigjet²⁶ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit S. dhe F. H.(shitësit e pasurisë) apo Xh. dhe L. Th. (huadhënësit).

❖ Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

1.14 Në lidhje me ndonjë *trajtim preferencial* të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar Udhëzimit nr. 1, datë 4.3.2004, për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2004. Sipas udhëzimit, rezultoi se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2004, për qytetin e Shkodrës, ishte 45.053 lekë/m². Apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti

²⁶Shkresat: nr. *** prot., J. B., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr. *** prot., J.B., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. *** prot., S. K., datë 24.6.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe nr.***prot., A. N., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

është me sipërfaqe 75 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, Komisionit i rezultoi se vlera e apartamentit ishte 3.378.975 lekë. Kjo vlerë është me e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 2.450.000 lekë, pra, 928.975 lekë. Nga Komisioni, u konstatua se dukej se pasuria ishte blerë më lirë se sa çmimet e tregut në qytetin e Shkodrës dhe për këtë i kaloi subjektit barrën e provës²⁷ për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

1.14.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka pretenduar se konstatimi nuk është i drejtë dhe ka deklaruar se: *“Blerja e banesës sime në qytetin e Shkodër është bërë në bazë të çmimeve të tregut, mbi llojin e banesës së blerë nga ana ime, vendndodhjes së saj, kohës së ndërtimit të pallatit ku ndodhet apartamenti dhe gjendjes në të cilën ishte kjo banesë kur u ble, gjendje e cila ekziston edhe sot”*. Në mbështetje të pretendimeve, subjekti ka argumentuar si vijon:

“Ne nuk i njihim shitësit e banesës dhe ata nuk kishin asnjë arsye të na bënin trajtim preferencial në caktimin e çmimit të shitjes.

Në përcaktimin e çmimit të kësaj banesë nuk mund t’i referoheni kosmos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2004, për shkak se kjo kosto i referohet çmimeve të banësive të ndërtimeve të reja dhe jo ndërtimeve të mëparshme.

Apartamenti i blerë nga ana ime ndodhet në një pallat, të ndërtuar në vitin 1985, në katin e gjathtë të tij, i cili ka patur dhe ka probleme tekniko-inxhinierike të konsiderueshme, të cilat kanë qenë të pranishme që në kohën e blerjes së këtij apartamenti dhe janë prezent edhe aktualisht

Pallati është ndërtuar përpara viteve 90 dhe nuk ka ashensor”.

Gjithashtu, subjekti, në mbështetje të pretendimeve, ka paraqitur fotografi të pallatit ku ndodhet apartamenti, disa kontrata të banorëve të pallatit ku banon dhe një aktekspertimi vlerësues për apartamentin, datë 12.10.2021 (i kryer, me kërkesë të subjektit, nga dy ekspertë të pavarur të licencuar që e kanë vlerësuar apartamentin se varion përafërsisht në vlerën 2.500.000 lekë në kohën e blerjes).

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.14.2 Trupi gjykues, në analizë të provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, vëren se pikësëpari fotot e paraqitura në pretendime, në mënyrë të qartë identifikojnë një apartament i cili ndodhet në një pallat të vjetër. Trupi gjykues nuk limitohet vetëm në këtë tregues, por duke iu referuar edhe aktit të ekspertimit vlerësues nga ekspertët e licencuar, ku identifikohen problematika apo mangësi të banësive, por edhe detaje teknike mbi gjendjen faktike të apartamentit dhe problematikat inxhinierike, krahasimisht me ndërtimet e reja (si p.sh. mospasja e ashensorëve), si dhe disa kontratave të ngjashme të depozituara nga subjekti, ku pasqyrohen blerës të tjerë të apartamenteve në të njëjtin pallat, madje me çmime edhe më të ulëta se ai me të cilin subjekti ka blerë këtë pasuri, krijon bindjen për mospasjen e një trajtimi preferencial të subjektit të rivlerësimit në përfitimin e kësaj pasurie.

2. Apartament në pronësi me sip. 92.4 m², në adresën: rruga “****”, shk. ***, k. ***, h. nr. ***, godinë 9-katëshe, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, blerë në vitin 2013 me çmimin 8.491.560 lekë, blerë me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat dhe me kredi bankare. Vlera është 8.491.560 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁸.

²⁷Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

²⁸Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

2.1 ILDKPKI në raportin e saj ka konstatuar: *“Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPPPP-ja dhe ZVRPP-ja Tiranë”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

2.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se pronësia për këtë apartament është e regjistruar në emër të bashkëshortit (P. P.), por është në bashkëpronësi.

2.3 Komisionit nga verifikimi i DPV-ve i rezultoi se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2013 me përshkrim: *“Blerje banese e përbashkët në rrugën ‘***’, shk. ***, kati ***, ap. nr. ***, në Tiranë, me sip. 92.4m², në vlerën 8.491.560 lekë”*²⁹. Në rubrikën e ndryshimeve të pasurisë dhe burimi i krijimit, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura të deklaruara më përpara gjendje cash gjithsej 7.700.000 lekë. Shuma e të ardhurave gjithsej gjendje cash (duke hequr shpenzimet vjetore, pagesën e banesës dhe kredinë) shuma 400.000 lekë”*.

Gjithashtu, në rubrikën e detyrimeve financiare dhe rubrikën mbi të dhënat konfidenciale ka deklaruar se ka marrë kredi për blerje banese në shumën 800.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, duke përcaktuar si datë fillimi për pagesën më 4.6.2013 dhe datë mbarimi më 4.6.2014.

2.4 ASHK-ja³⁰ ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie me nr. ***, z. k. ***, vol***, f. ***, në emër të bashkëshortit (P. P.) të subjektit të rivlerësimit. Sipas kontratës së shitjes së kësaj pasurie me nr***, datë 9.5.2013, rezultoi se pasuria është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shtetasi H. B., përfaqësuar me prokurën e përgjithshme me nr. ***, datë 14.1.2008, nga djali i tij Xh. B., në çmimin 8.491.560 lekë. Në kontratë është parashikuar se çmimi për shitjen e pronës, sipas rivlerësimit të bërë nga ZVRPP-ja Tiranë dhe sipas marrëveshjes mes palëve është paguar me para në dorë jashtë zyrës së noterit.

2.5 DPPPP-ja³¹ ka konfirmuar se në emër të shtetasit P. P. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) ka raportime të kontratave noteriale. Konkretisht është konfirmuar se në datë 9.5.2013, shtetasi P. P. ka blerë apartament me çmim të deklaruar 8.491.560 lekë, me palë shitëse shtetasin H. B., i datëlindjes 1.4.1965, sipas kontratës nr. ***, datë 9.5.2013, nënshkruar para noteres A. S. me NIPT ***. Kjo kontratë është konfirmuar edhe nga verifikimi i RNSH-së³².

2.6 FSHU-ja³³ nuk ka konfirmuar kontratë për furnizim me energji elektrike në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Subjektit i është kërkuar³⁴ të depozitojë kontratën e furnizimit me energji elektrike me FSHU-në për këtë pasuri dhe librezën përkatëse që i përket kontratës. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit ka sqaruar se: *“Ne nuk kemi kontratë furnizimi me OSHEE-në Tiranë, për këtë banesë, pasi ne nuk kemi bërë ndryshimet e emrit të klientit nga H.B., pronari i mëparshëm i banesës, te ne që jemi pronarët aktual të këtij apartamenti. Kjo edhe për faktin se në këtë apartament shkojmë shumë rrallë dhe nuk jetojmë në Tiranë. Pra, kontrata e furnizimit me energjinë elektrike për apartamentin tonë me adresë: rruga ‘***’, shkalla e parë, kati i dytë, hyrja nr. ***, godinë 9-katëshe, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, është në emrin e shitësit H. B. . Për sa i përket librezave të energjisë elektrike për këtë apartament, ne i disponojmë ato, ku edhe ato janë në emrin e H. B.”*. Në mbështetje të përgjigjes, subjekti ka depozituar librezat e energjisë elektrike në vite për banesën në Tiranë,

²⁹Të njëjtin deklaram ka bërë edhe bashkëshorti i subjektit (si në deklaratën e subjektit në cilësinë e personit të lidhur edhe në deklaratën e interesave private në cilësinë e personit deklarues, si prokuror).

³⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2020, në dosjen e Komisionit.

³¹Referojuni shkresës nr. ***prot., datë 15.5.2020, në dosjen e Komisionit.

³²Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 21.5.2020, në dosjen e Komisionit.

³³Me shkresën nr***prot., datë 15.5.2020, në dosjen e Komisionit.

³⁴Me pyetësorin nr. 2, datë 15.6.2021.

si dhe pagesat bankare të kryera nga llogaria e pagës së saj për OSHEE-në, për periudhën e pandemisë, sipas shpjegimeve të subjektit.

2.7 UKT-ja³⁵ nuk ka konfirmuar kontratë për furnizimin me ujë në emër të subjektit dhe bashkëshortit. Subjektit i është kërkuar³⁶ të depozitojë kontratën për shërbime me UKT-në, për këtë pasuri dhe librezën përkatëse që i përket kontratës. Subjekti rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit ka dhënë të njëjtët argumente si për kontratën me FSHU-në. Në mbështetje të përgjigjes ka depozituar librezat përkatëse të furnizimit me ujë në vite për banesën në qytetin e Tiranës, si dhe pagesat bankare të kryera nga llogaria e pagës së saj për UKT-ja, për periudhën e pandemisë sipas shpjegimeve të subjektit.

- Për sa më sipër, nga dokumentacioni i administruar, trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit. Gjithashtu, nga hetimi i kryer, trupi gjykues vëren se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

2.8 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim i kësaj pasurie janë: (i) kursimet, ndër vite, nga të ardhurat; si dhe (ii) kredi bankare.

2.8.i Në lidhje me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga të ardhurat në deklaratën e interesave periodike për vitin 2008 dhe në vazhdim si vijon:

Tabela nr. 1

Viti	Përshkrimi	Vlera	Shuma e akumuluar
2008	Të ardhura të krijuara gjatë vitit 2008 nga paga ime dhe e bashkëshortit, gjendje <i>cash</i> (banesë) - e përbashkët	1,200,000	1,200,000
2009	Të ardhura të krijuara gjatë vitit 2009 (kursime) nga paga ime dhe e bashkëshortit tim, gjendje <i>cash</i> (në banesë), në detyrën e prokurores dhe prokurorit të rrethit, si dhe raportet e mia të lindjes (shuma e përgjithshme) Shuma e të ardhurave totale (kursimeve) gjendje <i>cash</i> në banesë e përbashkët (shuma e përgjithshme) 2.400.000 lekë	1,200,000	2,400,000
2010	Të ardhura të krijuara gjatë vitit 2010 nga paga ime dhe e bashkëshortit, si prokuror rrethi, gjithsej shuma lekë <i>cash</i>	1,500,000	3,900,000
2011	Të ardhura të krijuara gjatë vitit 2011 nga paga ime si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe bashkëshortit si prokuror rrethi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë, gjithsej shuma	2,100,000	6,000,000
2012	Të ardhura të krijuara gjatë vitit 2012 nga paga ime si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe bashkëshortit tim si prokuror rrethi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë. Gjendje <i>cash</i> , gjithsej shuma	1,700,000	7,700,000
2013	Të ardhura të deklaruara më përpara gjendje <i>cash</i> gjithsej 7.700.000 lekë. Shuma e të ardhurave gjithsej gjendje <i>cash</i> (duke hequr shpenzimet vjetore, pagesën e banesës dhe kredinë) 400.000 lekë	400,000	400,000

³⁵Me shkresën nr. ***prot., datë 14.5.2020.

³⁶Me pyetësorin nr. 2, datë 15.6.2021.

2.8.i.a Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësinë e krijimit të kursimeve të deklaruara nga subjekti. Në analizën financiare u konstatua se dukej se subjekti i rivlerësimit, rezultonte në pamundësi për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe për të krijuar kursimet në vlerën 228.473 lekë, në vitin 2011 dhe në vlerën 60.849 lekë, në vitin 2012 dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës³⁷ për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

2.8.i.b Lidhur me konstatimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *“Është jo i drejtë dhe ka ardhur si rrjedhojë e mospërfshirjes në të ardhurat e familjes sime, për vitet 2011 dhe 2012, të pagesës së marrë nga bashkëshorti im për shpenzimet e transportit (bonusi) dhe dietat”*. Subjekti ka pretenduar se jo e gjithë shuma e përcaktuar për shpenzime transporti është konsumuar nga bashkëshorti i saj, për shkak të punës së tij si ish-drejtues prokurorie dhe ka kërkuar që pjesa e mbetur nga kjo e ardhur të llogaritet si kursim për vitet 2011 dhe 2012.

Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit ka referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendime³⁸ marrë nga ky i fundit.

Subjekti ka pretenduar se: *“... nëse vlerës së bilancit negativ të nxjerrë nga ekspertja e Komisionit i zbresim këtë vlerë të të ardhurave të kursyera nga bonusi i udhëtimit nga bashkëshorti im, për vitin 2012 rezulton një bilanc pozitiv në vlerën 20.319 lekë (81.168 - 60849=20.319 lekë)”*.

Subjekti ka pretenduar se bashkëshorti i saj, për transport ka përdorur automjetin në pronësinë e tyre “Mercedes-Benz Daimler Chrysler C200 CDI”, me targa *** dhe për të vërtetuar pretendimet ka paraqitur: (i) aktekspertimin teknik vlerësues të ekspertit teknik, Ing.H. M., datë 8.10.2021; (ii) urdhrin nr. **, datë 30.9.2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë; si dhe (iii) urdhrin nr**, datë 31.8.2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *“Nga analiza financiare e kryer nga ekspertët e Komisionit rezulton se nuk më janë njohur si të ardhura të ligjshme dietat që ka përfituar bashkëshorti gjatë viteve 2011 – 2012”*.

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni, që për të shmangur përlllogaritjen dy herë të shpenzimeve të transportit (shpenzime jetese + dieta), dietat e bashkëshortit ose të njihen si të ardhura të ligjshme ose në shpenzimet për jetesë, sipas standardeve të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, të mos përfshihen shpenzimet e transportit në vlerën e dietave.

Më tej, subjekti ka pretenduar se: *“Nëse mua do të më njihen dietat e bashkëshortit për vitin 2011 dhe të ardhurat nga bonusi i transportit, atëherë unë rezultojë me një bilanc pozitiv në vlerën 36.659 lekë”*.

Për sa i përket vitit 2012, me të njëjtin argumentim dhe logjikë, nëse do të më njihen dietat e bashkëshortit për vitin 2012 dhe të ardhurat nga bonusi i transportit, atëherë unë rezultojë me një bilanc pozitiv në vlerën 167,811 lekë”.

Në lidhje me këtë pretendim subjekti ka paraqitur: (i) vërtetimin nr. *** prot., SK, datë 28.10.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë, dorëzuar bashkë me deklaratën *Vetting*; si dhe (ii) dietat për vitet 2011 dhe 2012.

³⁷Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

³⁸Për më shumë referojuni parashtrimeve të subjektit, depozituar në datën 15.10.2021 në Komision.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.8.i.c Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve dhe kërkimeve të subjektit për të kryer rilogaritje në analizën financiare për këtë rast, konkludon se të dy pretendimet e subjektit për të përfshirë në analizë të ardhurat e përfituara nga dietat dhe bonusi i transportit për bashkëshortin, nuk qëndrojnë. Pavarësisht se subjekti pretendon se bashkëshorti nuk e ka konsumuar të gjithë vlerën e bonusit të transportit dhe ka paraqitur përlllogaritjet e një eksperti autoteknik, inxhinier mekanik për sasinë e karburantit të shpenzuar nga automjeti që zotërojnë dhe koston totale, trupi gjykues nuk mund ta marrë në konsideratë këtë pretendim. Kjo është një praktikë e konsoliduar tashmë edhe nga Kolegji i Apelit në vendimet e tij³⁹, ku bonusi i transportit nuk mund të përfshihet si e ardhur, pasi është dhënë nga punëdhënësi për të mbuluar një shpenzim të konsideruar të kryer nga subjekti dhe, si i tillë, destinuar në funksion të ushtrimit të detyrës, për mbulimin e kostove të transportit të lidhura me ushtrimin e saj. I njëjti qëndrim vlen edhe për dietat⁴⁰ të cilat jepen me qëllim rimbursimit të shpenzimeve dhe jo për kursim. Për pasojë, rezultati financiar në këtë rast mbetet i pandryshueshëm.

2.8.ii Në lidhje me kredinë bankare

Komisioni ka administruar kontratën e kredisë, datë 25.4.2013, në “Raiffeisen Bank”, me palë kredimarrëse subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin.

Nga verifikimi i aktit rezultoi se kredia në shumën 800.000 lekë, ishte akorduar për një afat 13-mujor. Sipas kësaj kontrate⁴¹ rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, si kredimarrës kanë përfituruar një kredi në shumën 800.000 lekë, duke përcaktuar që *qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi për arsye personale*.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, Komisionit i rezultoi se kredia ishte disbursuar në datën 25.4.2013 dhe ishte lëvruar për llogari të bashkëshortit të subjektit. Ky i fundit pas disbursimit të kredisë kishte kryer transaksionet konkretisht: (i) në datën 25.4.2013 kishte transferuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit shumën 190.000 lekë me përshkrimin mbyllje *overdrafti*; (ii) në datën 26.4.2013 kishte tërhequr shumën 500.000 lekë; (iii) në harkun kohor 26.4.2013 – 9.5.2013, kur është nënshkruar kontrata për blerjen e apartamentit, rezultoi se bashkëshorti i subjektit kishte kryer disa tërheqje.

2.8.iii Komisioni kreu analizën për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në këtë pasuri, nga ku u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

2.9 Në lidhje me gjendjen e *konfliktit të interesit*, Komisioni ka mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, të cilat në përgjigjet⁴² e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit H. B. apo Xh. B. .

- Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

2.10 Në lidhje me ndonjë *trajtim preferencial* të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, Komisioni i është referuar Udhëzimit nr. ***, datë 8.5.2013, për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2013. Sipas udhëzimit,

³⁹Vendimet nr. ***, datë 16.9.2019; nr. ***, datë 30.9.2020; dhe nr. ***, datë 12.5.2021.

⁴⁰Vendimi nr. 7, datë 5.4.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁴¹Pika I e nenit 1, “Kredia, objekti dhe qëllimi i saj”.

⁴²Shkresat: nr. *** prot., J.B., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. *** prot., J.B., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.*** prot., S.K., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; dhe nr. *** prot., A.N., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

rezultojn se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2013, për qytetin e Tiranës, është 89.700 lekë/m².

Apartamenti i blerë nga bashkëshorti i subjektit është me sipërfaqe 92.4 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultojn se vlera e apartamentit është 8.288.280 lekë. Vërehet se kjo vlerë është me e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 8.491.560 lekë.

❖ Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë trajtim preferencial ndaj subjektit të rivlerësimit në përfitimin e kësaj pasurie.

3. Automjet në pronësi, tip “Mercedes-Benz”, me targa *, e ndryshuar në targën ***, blerë në vitin 2010, me çmimin 300.000 lekë, blerë me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se pronësia për këtë automjet është e regjistruar në emër të bashkëshortit (P. P.), por është në bashkëpronësi. Vlera është 300.000 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴³.

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar: *“Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

3.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2010 me përshkrim: *“Shpenzime për blerje mjeteve autoveture Benz me targa ***, sipas kontratës me nr. ***, datë 28.7.2010, me vlerë 300.000 lekë”*⁴⁴.

Në vijim, u vërejt se subjekti në DPV-në e vitit 2010 nuk e kishte deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat.

3.3 DPSHTRr-ja⁴⁵, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Mjeteve, nuk e ka konfirmuar ekzistencën e këtij automjeti në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. P. P., ndërsa subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar⁴⁶ edhe praktikën e blerjes së kësaj pasurie. Nga verifikimi i kontratës nr. ***, datë 28.7.2010, me palë shitëse B. H. dhe palë blerëse P. P., në këtë praktikë të administruar, provohet blerja e kësaj pasurie në shumën 300.000 lekë. Në kontratë parashikohet se: *“Palët deklarojnë se janë likuiduar në mes tyre për këtë shumë shitblerje dhe se nuk kanë më asnjë lloj detyrimi as tani dhe as në të ardhmen”*.

3.4 AMF-ja⁴⁷, pas mbledhjes së informacionit nga shoqëritë e sigurimit, ka informuar se rezultojn policia sigurimi për automjetin me targa ***.

3.5 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

3.5.1 Subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 1, datë 15.5.2020, ka deklaruar se: *“Në datën 28.7.2010 kemi blerë automjetin tip ‘Mercedes-Benz’⁴⁸, me targa *** (targa e vjetër ***), në*

⁴³Kontratë shitblerjeje pasuri e luajtshme nr. ***, datë 28.7.2010, me palë shitëse B. H. dhe palë blerëse P. P., të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në vlerën 300.000 lekë; certifikatë pronësie e automjetit rrugor me targa ***; leje qarkullimi e automjetit rrugor me targa ***; deklaratë doganore datë 11.7.2010; vërtetim nr. ***, datë 2.3.2016, nga DPSHTRR-ja Shkodër, i cili vërteton se automjeti me targa ***, ka pasur targën ***; leje qarkullimi (Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁴Të njëjtin deklaram ka bërë edhe bashkëshorti i subjektit (si në deklaratën e subjektit në cilësinë e personit të lidhur dhe në deklaratën e interesave private në cilësinë e personit deklaruës, si prokuror).

⁴⁵Referojuni shkresës nr*** prot., datë 18.5.2020, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020.

⁴⁸Vit prodhimi 1999.

vlerën 300.000 lekë. Ky automjet është blerë nga të ardhurat nga paga ime dhe bashkëshortit si prokurorë”.

3.5.2 Subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve në deklaratën e vitit 2010 në shumën 1.500.000 lekë. Meqenëse ishte e pamundur të përcaktohej vlera e saktë e kursimit, Komisioni kreu analizën financiare vjetore, pasi në vitin 2009 subjekti dispononte 2.400.000 lekë gjendje *cash*, shumë më se e mjaftueshme për të investuar në blerjen e automjetit në vlerën 300.000 lekë.

❖ Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues, sipas fakteve të dala më sipër dhe përllëgaritjeve financiare të kryera, konkludon se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë; si dhe (ii) subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të investojë në blerjen e automjetit si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

4. Automjet në pronësi, tip “Volkswagen Polo”, me targa *, blerë në vitin 2016 me çmimin 60.000 lekë, blerë me kursimet, ndër vite, nga të ardhurat. Vlera është 60.000 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshortin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁹.**

4.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar: “Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja”.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

4.2 Komisionit, nga verifikimi i DPV-ve, i rezultoi se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar në vitin 2016 me përshkrim: “Blerë automjet tip veturë e markës ‘Volkswagen Polo’⁵⁰, me targa ***, më çmim 60.000 lekë, me paratë nga të ardhurat. Pronësia është regjistruar në emër të bashkëshortit tim P.P., por është në bashkëpronësi”.

4.3 DPSHTRr-ja⁵¹, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Mjeteve, ka konfirmuar se automjeti me targa *** ishte në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

4.3.1 Në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të luajtshme nr. ***, datë 12.10.2016, me palë shitëse K. Ll. P.⁵² dhe palë blerëse P. P., parashikohet se *shuma e shitjes së automjetit është paguar tërësisht mes palëve në cash*.

4.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

4.4.1 Meqenëse vlera e investimit është në një shumë të papërfillshme dhe është kryer pothuajse në fund të vitit, analiza financiare për këtë pasuri nuk është kryer në momentin e investimit por është paraqitur vjetore.

4.4.2 Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016 se ka shpenzuar shumën 1.713.029 lekë për shpenzime të ndryshme (familjare, shkollë, kopsht, transport pune, shëndetësore, blerje automjeti, etj.). Në analizën financiare, shpenzimet e kryera për shkollimin dhe blerjen e automjetit janë identifikuar si zë më vete. Shuma e këtyre shpenzimeve është zbritur nga vlera totale e deklaruar prej subjektit.

Nga Komisioni, në analizën financiare, u konstatua se dukej se subjekti i rivlerësimit rezultonte në balancë negative në shumën 120.561 lekë dhe, për pasojë, i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

⁴⁹Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁰Vit prodhimi 2000.

⁵¹Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 18.5.2020, në dosjen e Komisionit.

⁵²Përfaqësuar me prokurë të posaçme nr***, datë 3.10.2016, nga z. V. Sh. (datëlindje 16.9.1975, me ID ***).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit

4.4.3 Lidhur me konstatimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *“Është jo i drejtë, për shkak se në analizën financiare të këtij viti, bashkëshortit tim i është llogaritur fitimi neto, por nuk i janë llogaritur shpenzimet për ushtrimin e profesionit të avokatit”*. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se: *“Në lidhje me DPV-në e vitit 2016, si unë ashtu dhe bashkëshorti, jemi munduar të pasqyrojmë me korrektësi të ardhurat dhe shpenzimet. Për sa i përket të ardhurave të bashkëshortit tim, në DPV-në e vitit 2016, ai ka pasqyruar vlerën 160.000 lekë nga arkëtimet e faturave të likuiduara, për vitin 2016 (pa TVSH). Ky fakt rezulton si nga DPV-të e vitit 2016, po ashtu dhe nxjerrja e llogarisë së tij bankare për vitin 2016, të cilën do t’jua vë në dispozicion. Për sa i përket shpenzimeve, në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme në DPV-në e vitit 2016, f. 6, ne kemi përcaktuar vlerën totale të shpenzimeve, ku kemi përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet e bëra nga bashkëshorti për ushtrimin e profesionit të avokatit. Pra, në totalin e shpenzimeve të mia si subjekt deklarues, janë përfshirë edhe shpenzimet që ka bërë bashkëshorti për ushtrimin e veprimtarisë së avokatit, për vitin 2016... një rrethanë tjetër që provon pretendimet e mia është fakti se në rubrikën “detyrimet financiare ndaj personave juridik dhe fizikë” të kësaj DPV-je, bashkëshorti im ka përfshirë edhe detyrime ndaj DRT-ja Shkodër dhe detyrime të klientëve të tij. Po t’i referohemi “formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, të vitit 2016, datë 4.2.2017, rezulton se shpenzimet për këtë vit janë në vlerën 123.400 lekë. Nëse rubrikës “shpenzime të ndryshme, familjare, shkollë, transport, shëndetësore, blerje mjeti etj.” të nxjerrë nga eksperti i Komisionit, në vlerën 1.519.529, do t’i zbresim shpenzimet e bashkëshortit të avokatisë, në vlerën 123.400 lekë (të përfshira brenda këtyre shpenzimeve), atëherë vlera e shpenzimeve familjare do të jetë në shumën 1.396.129 lekë, e cila është vlera e saktë”*.

Subjekti në mbështetje të shpjegimeve ka paraqitur: (i) DPV-në e vitit 2016; (ii) formularin e deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të vitit 2016, datë 4.2.2017; si dhe (iii) llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit për vitin 2016, në “Raiffeisen Bank”.

Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të njohë shpenzimet e avokatisë së bashkëshortit, të përfshira në DPV-në e vitit 2016 ose në totalin e shpenzimeve për këtë vit të zbresë këto shpenzime (avokatisë), ku sipas tij rezulton me bilanc pozitiv për këtë vit, në vlerën 2.839 lekë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

4.4.4 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson të mos e marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit dhe në këtë kontekst arsyeton si vijon:

Subjekti ka deklaruar pothuajse në mënyrë të detajuar shpenzimet familjare, ndërsa nuk specifikon shpenzimet e aktivitetit të bashkëshortit, në profesionin e lirë të ushtruar prej tij si avokat. Bashkëshorti i subjektit, ashtu siç ka deklaruar detyrimet tatimore apo faturat e pashlyera nga klientët e tij, duhet të kishte treguar kujdes edhe në deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga ushtrimi i aktivitetit të tij privat si avokat. Udhëzimi nr. 4095/2016 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së ka rregulluar/normuar mënyrën e deklarimit të personave fizikë dhe juridikë si persona të lidhur me deklaruesin. Në këtë rast personi fizik (aktiviteti avokat i bashkëshortit të subjektit) duhet të deklaronte saktësisht të gjitha të ardhurat, shpenzimet, detyrimet, pasuritë veçmas, etj. Për pasojë, për sa kohë nuk është përmbushur detyrimi ligjor sipas legjislacionit të fushës, rezultati negativ prej 120.561 lekësh mbetet i pandryshueshëm.

5. Gjendje në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me aktivitet privat avokat, referuar deklaratës Vetting të vitit 2017, në vlerën 394.51 lekë. Subjekti i ka

bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare⁵³, datë 18.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit P. P., i cili ka llogari si person fizik, në shumën 394 lekë.

- ❖ Trupi gjykues, nën konstatimin se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2020, ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të z. P. P., me gjendje në datën 26.1.2017, në shumën 394.51 lekë, ka konkluduar se deklarimi i subjektit është i saktë.

6. Gjendje cash e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, ka rezultuar në vlerën 1.200 lekë, si pasuri e përbashkët.

- ❖ Trupi gjykues ka konkluduar se të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes *cash*, e cila është në një vlerë të papërfillshme.

Detyrime financiare

7. Huamarrje⁵⁴ në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë (UBA), për blerje apartamenti me vendndodhje në bulevardin “****” (ish-rruga “****”), lagjja “****”, p. ***, k. ***, Bashkia Shkodër, me kontratë nr. ***, datë 22.1.2005, në shumën 2.495.880 lekë, me kohëzgjatje 3-vjeçare, për periudhën 8.3.2005 – 8.2.2008, me interes mujor 69.330 lekë, në 36 këste mujore, në të cilën përfshihet huaja në shumën 2.000.000 lekë dhe interesat në vlerën 495.880 lekë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti, gjithashtu, ka deklaruar se detyrimi i mbetur për këtë kredi është 0 (zero) lekë, shlyer tërësisht. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr. *** prot., datë 26.10.2016, nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA)⁵⁵- Dega Shkodër, e cila vërteton se deri në këtë datë, shtetasi P.P. nuk ka pasur detyrime të mbetura në këtë bankë.

7.1 Kjo kredi është trajtuar në detaje në pikën nr. 1 të vendimit. Nga verifikimi përkatës i dokumentacionit të administruar rezultoi se kredia e marrë në vitin 2005 për blerjen e apartamentit është shlyer totalisht në vitin 2007.

7.2 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit bankar të administruar gjatë hetimit, nuk vërejtí ndonjë problematikë dhe ndërkohë konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të shlyejë këtë kredi përgjatë viteve 2005 – 2007.

8. Kredi për blerje apartamenti në rrugën “**”, shk. ***, k. ***, hyrja nr. ***, godinë 9-katëshe, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, në “Raiffeisen Bank”, dega Shkodër, në datën 25.4.2013, në vlerën 800.000 lekë, me interes 16.78 %, me afat 13-mujor, me pagesë totale principal + interesa në shumën 883.456,13 lekë, me këste mujore 67.729,25 lekë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se detyrimi i mbetur për këtë kredi është në shumën 0 (zero) lekë, shlyer tërësisht. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr. *** prot., datë 5.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”⁵⁶, e cila vërteton se deri në këtë datë, shtetasi P. P. nuk ka detyrime të mbetura në këtë bankë.**

8.1 Gjithashtu edhe kjo kredi është trajtuar më sipër, në pikën nr. 2 të vendimit. Nga verifikimi përkatës i dokumentacionit të administruar rezultoi se kredia e marrë në vitin 2013 për blerjen e apartamentit është shlyer në vitin 2014.

8.2 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit bankar të administruar gjatë hetimit, nuk vërejtí ndonjë problematikë dhe ndërkohë konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare ta shlyejë këtë kredi përgjatë viteve 2013-2014.

9. Huaja në *overdraftin* e pagës së subjektit të rivlerësimit, ndaj “Raiffeisen Bank”, deri në datën e deklarimit në deklaratën *Vetting*, në shumën 25.912,05 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur

⁵³Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴Referuar deklaratës *Vetting* të vitit 2017, por është deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2004.

⁵⁵Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁶Aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

deklaratës *Vetting*, nxjerrjen e llogarisë bankare⁵⁷ për pagën, datë 20.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të tij, me balancë të mbetur në vlerën - 25.912 lekë.

- ❖ Trupi gjykues, nën konstatimin se “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2020, ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerë negative 25.912,05 lekë, ka konkluduar se deklarimi i subjektit është i saktë.

10. Detyrime ndaj organeve tatimore të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të aktivitetit privat avokat deri në datën e deklarimit në deklaratën *Vetting*, në shumën 28.652 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr***prot., datë 24.1.2017, nga DRT-ja Shkodër⁵⁸, ku evidentohet detyrimi në vlerën 28.652 lekë. Për informacionin e kërkuar nga bashkëshorti i subjektit të deklarimit lidhur me të ardhurat dhe fitimin për vitin 2016, DPT-ja Shkodër ka evidentuar se nga ana e këtij të fundit nuk është dorëzuar deklarata për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

10.1 Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve⁵⁹ rezultoi se bashkëshorti i subjektit, P. M. P., ka aktivitet në emër të tij. Gjithashtu, rezultoi se aktiviteti në fushën juridike ishte themeluar më 17.3.2016 dhe, aktualisht, është në status pasiv. Nga dokumentacioni i administruar nga kjo drejtori nuk rezultojnë detyrime. Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit për detyrimet ndaj organeve tatimore përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting* i ka korresponduar detyrimeve tatimore për muajin dhjetor, të cilat paguhen në muajin pasardhës (janar 2017).

10.2 Gjithashtu, Komisioni, nisur nga fakti i konstatimit të disa të ardhurave⁶⁰ të krijuara nga bashkëshorti i subjektit për shkak të ushtrimit të profesionit të tij (avokat-klient), mbajti korrespondencë⁶¹ me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit për të vlerësuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi në ushtrim të detyrës së kësaj të fundit me klientët e bashkëshortit. Në përgjigjet e përcjella, në asnjë rast nuk u konfirmua shqyrtimi i çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shtetasit E. Xh. H., S.A.L., A.M. M., A.N. K., J. R. Rr., G.F.Y. dhe K.E.M., si klientë të mbrojtur nga bashkëshorti i subjektit në çështje të ndryshme.

10.3 Trupit gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, nuk i rezultuan problematika lidhur me këtë çështje në tërësi, përfshirë këtu edhe çështjen e konfliktit të interesit.

Të dhëna konfidenciale

11. Hua e marrë dorazi nga kunati i subjektit të rivlerësimit, B.P., në shumën 300.000 lekë, në qershor të vitit 2014, për shpenzime të ndryshme, me afat pagesë të papërcaktuar, e pashlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin datë 25.10.2016, nga Qendra Shëndetësore Bathore Tiranë⁶², me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi B. P. është mjek familje pranë kësaj qendre shëndetësore.

11.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se: *“Për justifikimin e mundësisë financiare të huadhënësit, subjekti ka paraqitur vërtetim për punësimin e tij, por nuk ka paraqitur kontratë huaje”*.

⁵⁷Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁸Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 1.5.2020.

⁶⁰Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹Shkresat: nr. *** prot., J.B., datë 9.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. *** prot., datë 28.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; nr***prot., A. N., datë 28.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

⁶²Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

11.2 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2014, Komisionit i rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë hua me përshkrimin: *“Marrë hua (hua) dorazi nga kunati im B. P. në muajin qershor të vitit 2014 për shpenzime të ndryshme”*.

11.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit⁶³ të deklarojë mbi burimin e krijimit të shumës së marrë hua, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

11.4 Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se: *“... nga kunati im B. P. më është thënë se shuma prej 300.000 (treqind mijë) lekësh që më është dhënë hua në qershor të vitit 2014 është krijuar nga kursimet nga të ardhurat e tij nga paga si mjek. Kunati im B. P. ka rreth 27 vjet që ushtron profesionin e mjekut. Sipas të dhënave që ai më ka dhënë, ai ka filluar punë si mjek i përgjithshëm në datën 16.10.1994, në varësi të Komunës R., Dibër. Nga data 18.8.2005 e deri aktualisht ushtron detyrën e mjekut të familjes përsëri në Qendrën Shëndetësore Bathore, por në varësi të Drejtorisë së Shërbimit Parësor Tiranë ju bëj me dije faktin se nga kunati im B.P. më është thënë se djali i madh i tij N. P. që nga qershori i vitit 2011 shkon herë pas here në emigracion, për të punuar duke siguruar të ardhura monetare. Në lidhje me të ardhurat e tij si emigrant, nga ana e kunatit tim nuk më është siguruar ndonjë dokument provues, por në lidhje me hyrje – daljet e tij nga territori i vendit tonë, ju kërkoj me mirësjellje që t'i merrni ato nga sistemi TIMS, pasi mua nuk më vihen në dispozicion këto të dhëna”*.

11.5 Komisioni hetoi lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit me qëllim dhënien e huas dhe në këtë drejtim mbajti korrespondencë me institucionet shtetërore.

11.5.1 DPT-ja me shkresën nr***prot., datë 1.7.2021 dhe ISSH-ja me shkresën nr***prot., datë 24.6.2021, kanë informuar mbi punësimin e shtetasit B. P. në Qendrën Shëndetësore Bathore që prej vitit 2012 deri aktualisht. Sipas *statement*-it bankar⁶⁴ të “Credins Bank” identifikohet marrja e pagës në këtë bankë prej tetorit të vitit 2008 deri aktualisht.

Në raport me shumën e dhënë hua, Komisioni ka përllogaritur vetëm totalin e të ardhurave për periudhën janar 2012 – qershor 2014, sipas *statement*-it bankar⁶⁵, kur është dhënë kjo hua, nga ku konkludoi se të ardhurat rezultojnë në shumën 1.856.418 lekë. Lidhur me këtë shumë, duke i zbritur shpenzimet e jetesës, rezultoi se huadhënësi ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë këtë hua.

11.5.2 Gjatë hetimit⁶⁶, Komisionit i rezultoi se kjo hua është shlyer në vitin 2019 në rrugë bankare.

11.6 Trupit gjykues, në analizë të dokumentacionit bankar⁶⁷ të administruar gjatë hetimit, nuk i rezultuan problematika lidhur me këtë çështje dhe, po ashtu, vërejti se bashkëshorti i subjektit më 25.9.2019, ka depozituar në llogarinë e z. B. P. në “Credins Bank”, shumën 300.000 lekë me përshkrimin “shlyerje detyrimi qershor 2014”.

12. Hua e marrë dorazi nga kunata e subjektit të rivlerësimit, L. D.(P.), në shumën 300.000 lekë, në janar të vitit 2016, për të paguar licencën e avokatit për bashkëshortin e subjektit, P.P., si dhe për shpenzime të ndryshme, me afat pagese të papërcaktuar, e pashlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* vërtetimin nr. *prot., datë 24.10.2016, nga Qendra Shëndetësore A. Dibër⁶⁸, i cili vërteton se znj. L.D.**

⁶³Me pyetësin nr. 2, datë 15.6.2021.

⁶⁴Shkresë nr***prot., datë 5.7.2021.

⁶⁵Shkresë nr. ***prot., datë 5.7.2021.

⁶⁶Pyetësor nr. 1, datë 15.5.2020.

⁶⁷Shkresë nr. ***prot., datë 5.7.2021, nga “Credins Bank”.

⁶⁸Aneks nr. 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së.

është me detyrë infermiere pranë qendrës shëndetësore “A.”, në fshatin G. dhe vërtetimin datë 24.10.2016, nga Bashkia Dibër, i cilit vërteton se z. G. D. (Bashkëshorti i kunatës së subjektit të rivlerësimit) është me detyrë specialist agronom në Sektorin e Mjedisit të Tokës, pranë Drejtorisë së Bujqësisë së Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

12.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se: *“Për justifikimin e mundësisë financiare të huadhënësës, subjekti ka paraqitur vërtetimin për punësimin e saj, por nuk ka paraqitur kontratë huaje”*.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit

12.2 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2016, Komisionit i rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë hua, me përshkrim: *“Huaja (hua), e marrë dorazi nga kunata ime L. D. (P.) në shumën 300.000 (treqind mijë) lekë, në muajin janar të vitit 2016, për të paguar licencën e avokatit në janar të vitit 2016 për bashkëshortin tim P. P., si dhe për shpenzime të ndryshme, me afat pagese të papërcaktuar, e pashlyer”*.

12.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit⁶⁹ të deklarojë mbi burimin e krijimit të shumës së marrë hua, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

12.4 Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka sqaruar se: *“... nga kunata ime më është thënë se shuma që na kanë dhënë huaj prej 300.000 (treqind mijë) lekësh, në janar të vitit 2016, është krijuar si rrjedhojë e kursimeve të saj nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit G. D. . Kunata ime, së bashku me bashkëshortin kanë banuar gjithmonë dhe vazhdojnë të banojnë aktualisht në fshatin G., Njësia Administrative A., Bashkia Dibër. Sqaroj se bashkëshorti i kunatës sime, shtetasi G. D., ka punuar para viteve 90’ në detyrën agronom në Kooperativën Bujqësore A., ku edhe kishte vendbanimin, periudhë për të cilën nuk disponoj dokument. Pas viteve 90’ ka punuar si punonjës policie në Komisariatit e Policisë Dibër, punonjës në Komunën A. dhe Bashkinë Dibër”*.

12.5 Komisioni hetoi lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të huadhënësit, me qëllim dhënien e huas dhe ,në këtë drejtim, mbajti korrespondencë me institucionet shtetërore.

12.5.1 DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021 dhe ISSH-ja me shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2021, kanë informuar mbi punësimin e shtetases L. D. pranë Qendrës Shëndetësore A. dhe shtetasit G. D. pranë Komunës A. dhe Bashkisë Dibër prej vitit 2012.

12.5.2 Nga përllogaritja e Komisionit rezultoi se totali i të ardhurave, për periudhën janar 2012 – janar 2016, kur është dhënë kjo hua, është në vlerën 2.816.812 lekë, për çiftin D. . Lidhur me këtë shumë, duke i zbritur shpenzimet e jetesës, rezultoi se vlera e mbetur është e mjaftueshme për të dhënë këtë hua.

12.5.3 Gjatë hetimit⁷⁰, Komisionit i rezultoi se kjo hua është shlyer në vitin 2018 në rrugë bankare.

12.6 Trupit gjykues, në analizë të dokumentacionit bankar⁷¹ të administruar gjatë hetimit, nuk i rezultuan problematika lidhur me këtë çështje dhe, po ashtu, vërejtja se bashkëshorti i subjektit më 13.12.2018, ka depozituar nga llogaria e aktivitetit të tij si person fizik, në llogarinë e z. G.D. në “Raiffeisen Bank”, shumën 300.000 lekë, me përshkrimin “shlyerje huaje në janar të vitit 2016”.

13. Detyrim i shtetasit G. Y. ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit P.P., si avokat me NIPT ***, në shumën 100.000 lekë, bashkë me TVSH deri në ditën e deklarimit. Faturë

⁶⁹Me pyetësorin nr. 2, datë 15.6.2021.

⁷⁰Pyetësor nr. 1, datë 15.5.2020.

⁷¹Shkresë nr. ***prot., datë 15.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

tatimore shitjeje nr. ***, datë 2.11.2016, dhe numër serie ***. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës faturë tatimore shitjeje me nr. ***, datë 2.11.2016, në vlerën 100.000 lekë⁷².

14. Detyrim i shtetasit K. M. ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit P. P., si avokat me NIPT ***, në shumën 72.000 lekë, bashkë me TVSH deri në ditën e deklarimit. Faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 9.12.2016 dhe numër serie ***. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 9.12.2016, në vlerën 72.000 lekë⁷³.

14.1 Lidhur me pikat 13 dhe 14, Komisioni ka konstatuar se janë detyrime që rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit edhe në DPV-në e vitit 2016.

14.2 Komisioni, pasi analizoi llogarinë bankare të z. P.P., person fizik, konstatoi se në raport me faturimet e kryera, këta dy klientë nuk kanë paguar shërbimin e marrë nga bashkëshorti i subjektit brenda periudhës së deklarimit dhe në kushte të tilla trupi gjykues konkludon se deklarimi i bashkëshortit të subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

15. Z. P. M. P., avokat, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ushtrimi i profesionit të avokatit në Shkodër.

Trupi gjykues e ka trajtuar këtë çështje gjerësisht në pikën 10 të kësaj vendimmarrjeje, duke u fokusuar në ushtrimin e profesionit të avokatit të bashkëshortit të subjektit, në detyrimet tatimore dhe shlyerjet e tyre, si dhe në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me klientët e bashkëshortit të saj përgjatë ushtrimit të detyrës.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit/P. P.

16. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të njëjtat pasuri sikurse ka deklaruar edhe subjekti i rivlerësimit, të cilat trupi gjykues i ka trajtuar më sipër në vendim.

17. Komisioni bëri verifikimet e nevojshme edhe në sistemet AMF, *TIMS* dhe në korrespondencën e mbajtur me këto autoritete publike, si dhe në informacionin e pasqyruar në Regjistrin Noterial ku, në përfundim, vërejti se nuk konstatohen automjete në pronësi apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të apo edhe marrëdhënie të tjera kontraktore përveç atyre të deklaruara prej tyre.

17.1 Ndërsa nga verifikimi në sistemin *TIMS* u konstatuan disa automjete që kishte udhëtuar bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për të cilat subjekti ka qartësuar⁷⁴ mbi marrëdhënien me pronarët apo përdoruesit e automjeteve (shtetasit me iniciale L. T., B. Q., etj.), si dhe ka deklaruar se nuk ka hetuar, mosfilluar apo pushuar ndonjë çështje në ngarkim të këtyre shtetasve. Njëkohësisht⁷⁵, subjekti ka depozituar edhe vërtetimet përkatëse nga institucionet punëdhënëse ku konfirmohet ky fakt.

17.2 Në të tilla kushte, trupi gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit çmon se kjo çështje nuk shfaq ndonjë problematikë në adresë të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me kriterin e pasurisë, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 75 m², të të ardhurave për të justifikuar shpenzimet familjare dhe kursimet e deklaruara për vitet 2011, 2012 dhe 2016, duke u gjendur në balancë negative në vlerën 1.737.213 lekë dhe, për pasojë, nuk ka arritur

⁷²Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷³Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁴Me pyetësorin nr. 3, datë 30.7.2021 dhe pyetësorin nr. 4, datë 22.9.2021.

⁷⁵Me pyetësorin nr. 4, datë 22.9.2021 janë bashkëlidhur; shkresa nr. *** prot., J. B., datë 24.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresa nr. *** prot., A. N., datë 23.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; shkresa nr. ***prot., datë 23.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; dhe shkresa nr. *** prot., P. Ç., datë 23.9.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të bërë në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin me nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 24.3.2021, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, konstatoi *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi*.

1.2 Në raport citohet se nga informacioni i ardhur prej institucionit të verifikimit rezulton:

“Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar në mënyrë të pasaktë datën, muajin dhe vitin e lindjes, 6.8.1987, në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), pasi në certifikatën familjare dhe në kartën e identitetit figuron me datëlindje 6.8.1979.

*Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar person me precedent kriminal më 17.3.2014, nga Sektori për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, për arsye se me vendimin nr. ***, datë 8.12.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar masën e sigurisë ‘arrest në burg’ për veprën penale ‘korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë’. Me vendimin nr. ***, datë 30.12.2013, Gjykata e Apelit Tiranë ka ndryshuar masën e sigurisë nga ‘arrest në burg’ në ‘arrest në shtëpi’.*

*Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁷⁶ është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit P. P. për veprën penale ‘korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë’, në bazë të nenit 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, e dënon me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale e dënon të pandehurin P. P., përfundimisht, me 2 vjet burgim. Aktualisht çështja është në Gjykatën e Lartë, rekurs⁷⁷.*

Subjekti i rivlerësimit Ajola F. Prençi ka vetëdeklaruar në pjesën e 5 ‘të dhëna për sigurinë’ germa ‘b’, për çështjen penale në ngarkim dhe gjykim të bashkëshortit, shtetasit P. P., e cila në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikat 5 dhe 7, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, për rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin e faktit konsiderohet një rrethanë lehtësuese për subjektin e rivlerësimit, pasi është parashtruar prej saj në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Por, fakti që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është proceduar penalisht dhe dënuar për ‘korrupsion pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë’, e bën atë një person të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, dhe se në zbatim të kërkesave të parashikuara në pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me përcaktimin e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, si dhe në përcaktim të germave ‘b’ dhe ‘c’, të nenit 37, gjykohet se: (i) procedimi penal dhe më pas çështja penale në gjykim të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi, lidhet drejtpërdrejt me pastërtinë e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e

⁷⁶www.gjykata.gov.al

⁷⁷www.gjykataelarte.gov.al

personit të lidhur sipas përcaktimit të dhënë në ligj; (ii) përfshirja në veprimtari të kundërligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në formën e korrupsionit të prokurorit, i bën këta individë potencialisht të shantazhueshëm nga strukturat kriminale”.

1.3 DSIK-ja, pas kërkimit nga Komisioni për përditësimin e raportit të përcjellë dhe pasqyruar më sipër, ka dërguar raportin⁷⁸ e përditësuar dhe të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 16.9.2021, të KDZH-së.

1.3.1 Ndër të tjera, në këtë raport, citohet se:

- i. Për subjektin e rivlerësimit Ajola F. Prençi nuk disponohen të dhëna dhe nuk ka sinjalizime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.
- ii. Të dhënat e përcjella nga autoritetet verifikuese flasin vetëm për vëllain e znj. Ajola Prençi, ku informojnë për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës.
- iii. Vëllai i subjektit është gjithashtu subjekt rivlerësimi dhe do të shqyrtohet si i tillë.

1.4 Në përfundim, raporti i ka qëndruar të njëjtit konstatim si më parë për papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

1.5 Komisioni kreu hetim të thelluar lidhur me informacionin e pasqyruar në raportin e DSIK-së, me qëllim vërtetësinë dhe provueshmërinë e tij.

a. Në lidhje me plotësimin në mënyrë të pasaktë të rubrikës (data, muaji, viti i lindjes, 6.8.1987, në deklaratën për kontrollin e figurës, shtojca 3) nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit, konkretisht, nga këqyrja e pjesës së parë tek të dhënat identifikuese në këtë deklaratë, certifikatës familjare datë 20.1.2017, certifikatës personale datë 20.1.2017 (depozituar së bashku me deklaratën *Vetting*) dhe fotokopjes së kartës së identitetit (dokument shoqëruar me deklaratën për kontrollin e kriterit të figurës) me datë lëshimi 2.4.2009, konstatoi të njëjtën gjetje të pasqyruar në raportin e DSIK-së, pasi datëlindja e subjektit të rivlerësimit në këto akte rezultoi të jetë 6.8.1979 dhe jo 1987.

Në këto kushte dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), në rubrikën “data, muaji, viti i lindjes” dhe, për këtë shkak, i kërkoi subjektit të japë shpjegime, të cilat janë pasqyruar, arsyetuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues më poshtë, në tërësi të hetimit të këtij kriteri.

b. Në lidhje me dënimin penal të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni administroi dhe verifikoi deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3) të subjektit. Nga verifikimi përkatës rezultoi se në pjesën 5 “të dhëna për sigurinë”, germa “b” e deklaratës, subjekti është përgjigjur me “PO” dhe ka deklaruar ekzaktësisht se: *“Bashkëshorti im P. P., ish-Drejtues i Prokurorisë Pukë, është dënuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 319/ç) dhe 25 të Kodit Penal. Nga bashkëshorti im është pretenduar dhe mbajtur, në çdo fazë të procedimit, qëndrim për pafajësinë e tij. Aktualisht, çështja penale në ngarkim të tij është në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë. Për faktin në ngarkim të bashkëshortit tim jam vënë në dijeni në fund të nëntorit 2013, pas bërjes mediatike nga një televizion privat (Top Chanel)”.*

Komisioni, me shkresën nr. ***, datë 26.7.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka kërkuar informacion mbi çështjen penale në ngarkim të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (P. P.) dhe vënien në dispozicion të vendimeve gjyqësore përkatëse.

⁷⁸Raport nr. *** prot., datë 1.7.2021.

Në vijim, u administruan vendimet gjyqësore përkatëse⁷⁹, nga ku rezultoi se bashkëshorti i subjektit, me vendimin nr. ***, datë 4.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është deklaruar fajtor për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe në bazë të neneve 319/ç dhe 25 të Kodit Penal është dënuar me tre vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 23.9.2016. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri P. P. është dënuar me dy vjet burgim dhe rezulton se aktualisht çështja⁸⁰ ndodhet në Gjykatën e Lartë, në fazën e studimit të çështjes.

c. Komisioni, nga informacionet konfidenciale që nuk mund t’i vihen në dispozicion subjektit të rivlerësimit, është bërë me dije se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e saj kontaktin e papërshtatshëm të vëllait të saj A. Y. me të tretë.

c/i Në vijim të hetimit për këtë çështje rezultoi se shtetasi A. Y. është njëkohësisht subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si gjyqtar.

c/ii Pa paragjykuar, por për të ezauruar edhe këtë konstatim të institucionit ligjzbatues, Komisioni, me vendim të ndërmjetëm⁸¹, vendosi të administrojë deklaratën e plotësuar nga shtetasi A.Y. për llogari të kontrollit të tij për kriterin e figurës.

c/iii Nga verifikimi i kësaj deklarate rezultoi se në germën “ç”, të pjesës 5 “të dhëna për sigurinë”, z. A. Y., në përgjigje të pyetjes “A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës tuaj?”, është përgjigjur me “PO” dhe, në vijim, ka deklaruar ekzaktesisht: “I. K. M.: ish-kryetar i Komunës *** Shkodër. Ky person, në dijeninë time, të marrë rreth muajit qershor 2012, ka kryer në Itali një veprë penale trafikimi, por se çfarë lloj trafikimi nuk e mbaj mend. Dijeninë mbi këtë fakt e kam marrë për shkak të punës time, të asaj kohe, si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo, me rastin e paraqitjes në gjykatë të një kërkesë me objekt ‘lejim ekstradimi’. Për këtë shtetas, këtë kërkesë nuk e kam kërkuar unë, por një gjyqtar tjetër. Po ashtu sqaroj se që nga ajo kohë dhe aktualisht, unë nuk kam pasur asnjë kontakt me këtë shtetas. Për sa i përket natyrës së këtyre marrëdhënieve sqaroj se ato kanë filluar në vitin 2011, me sa mbaj mend, rreth muajit maj dhe shkak i tyre i referohet faktit se vëllai im, G. Y., në këtë kohë filloi punë në Komunën *** ku ishte kryetar shtetasi në fjalë. Unë kam pasur me këtë shtetas takime dhe telefonata (se sa dhe kur nuk e mbaj mend), por ato kanë qenë jo të shpeshta dhe nuk kanë qenë shprehje e ndonjë miqësie të ngushtë, por më tepër kanë qenë shprehje etike apo respekti formal. Sqaroj se këto kontakte janë ndërprerë menjëherë në kohën që kam marrë dijeni mbi sa më sipër. Po ashtu edhe vëllai im, me sugjerimin tim ka lënë punën”.

c/iv Ndërsa, nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës (shtojca 3), në germën “d”, të pjesës 5 “të dhëna për sigurinë”, të subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi, në përgjigje të pyetjes “Nëse është në dijeni që një nga anëtarët e familjes suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”, është përgjigjur “JO”.

Subjekti ka deklaruar ekzaktesisht: “... vëllai im gjyqtar A. Y. është pyetur si person që tregon rrethana hetimi nga Prokuroria për Krimet e Rënda dhe ka pasur kontakte me persona të përfshirë në proces. Nga vëllai im më është bërë i ditur fakti se kontaktet kanë qenë të përshtatshme dhe për shkak të detyrës. Nuk jam në dijeni për objektin e hetimit, personat e hetuar apo ecurinë e procesit. Kam marrë dijeni për faktin nga vëllai im në dhjetor të vitit 2014”.

⁷⁹Referojuni përgjigjes nr. ***prot., datë 29.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkëlidhur saj dhe fotokopjeve të vendimeve.

⁸⁰Nr. i çështjes: ***-2016.

⁸¹Nr. *** prot., datë 23.7.2021.

d. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁸² duke iu referuar të gjitha konstatimeve të Komisionit, në raport me të dhënat e plotësuar në deklaratën përkatëse dhe në raportin e DSIK-së në tërësi, si dhe të depozitave të dokumentacionit justifikues ligjor në mbështetje të deklaratimeve të saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.6 Subjekti, në lidhje me konstatimin e Komisionit se: “Duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), në rubrikën “data, muaji, viti i lindjes”, ndër të tjera, ka deklaruar ekzaktësisht se: *“Në lidhje me konstatimin tuaj ‘Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar në mënyrë të pasaktë rubrikën (data, muaji, viti i lindjes) 6.8.1987 në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), pasi në certifikatën familjare dhe kartën e identitetit figuron me datëlindje 6.8.1979’, shpjegoj se ky konstatim është tërësisht i saktë dhe në këtë drejtim nga ana ime pranohet gabimi në plotësimin e të dhënave në lidhje me vitin tim të lindjes.*

Datëlindja ime e saktë është 6.8.1979 dhe pasi u konsultova edhe me fotokopjen e aktit ‘Deklaratë për kontrollin e figurës’ (të ruajtur nga ana ime), të rubrika ‘të dhëna identifikuese’, konstatoj se gabimisht kam shënuar një vitlindje të gabuar. Për të sqaruar faktin se kjo ka qenë rrjedhojë vetëm e një gabimi material në shkrim dhe nuk ka pasur asnjë keqdashje në këtë drejtim, shpjegoj se unë kam deklaruar datëlindjen time të saktë në çdo akt tjetër që lidhet qoftë me procesin e vettingut apo me deklaratime të tjera periodike që kam bërë për shkak të detyrës”.

Subjekti ka shpjeguar që kjo është hera e parë që ka kryer një gabim të kësaj natyre dhe duke pranuar pasaktësinë ka kërkuar mirëkuptimin e Komisionit që kjo të konsiderohet si një veprim që nuk sjell asnjë pasojë në vlerësimin e figurës së saj.

1.7 Subjekti, në lidhje me konstatimet e Komisionit, në raport me të dhënat e plotësuar në deklaratën përkatëse dhe në raportin e DSIK-së në tërësi, ndër të tjera, ka paraqitur disa pretendime:

- i. Në lidhje me vlerësimin e DSIK-së *“si e papërshtatshme për vazhdimin e detyrës”*, subjekti e ka konsideruar këtë vlerësim si të papranueshëm, fyes, të padrejtë, keqdashës, diskretitues dhe të dhënë pa asnjë bazë objektive. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se:
 - gjatë eksperiencës 18-vjeçare nuk ka kryer veprime për të krijuar dyshime për përfshirjen “në kontakte të papërshtatshme” dhe për vlerësimin si “një person potencialisht i shantazhueshëm nga struktura kriminale”;
 - ka treguar vendosmëri të lartë në zbatimin me korrektësi të ligjit, pa qenë “pre” e asnjë ndikimi;
 - konstatimet e DSIK-së nuk i përkasin asaj, por konfondohen me persona të tjerë, me të cilët ka lidhje familjare dhe pa bërë një interpretim të saktë të ligjit nr. 84/2016, arrijnë në këtë konkluzion mbi supozime, pa pasur asnjë bazë objektive;
 - në raportin e DSIK-së, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 16.9.2021, në lidhje me të deklarohet se *“nuk disponohen të dhëna dhe nuk ka sinjalizime për përfshirje në veprimtari kriminale”*;
 - në raportin me nr. ***, datë 24.3.2017, të DSIK-së për kontrollin e figurës dhe me raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 24.3.2021, në lidhje me të nuk jepen vlerësime, por përcaktimi i figurës bëhet për shkak të bashkëshortit dhe vëllait gjyqtar.
- ii. Në lidhje me bashkëshortin P. P., subjekti ka shpjeguar se asnjëherë as e ka fshehur dhe as e fsheh çështjen penale të tij. Gjithashtu, subjekti, duke theksuar se në asnjë moment

⁸²Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

nuk e ka pranuar që bashkëshorti i saj është fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar, ka pretenduar se situata e bashkëshortit nuk mund të sjellë pasoja në vlerësimin e figurës së saj, për këto arsye:

- ka qenë korrekte në pasqyrimin e këtij informacioni, duke mos fshehur as faktin e ndodhur dhe as bindjen në lidhje me këtë fakt;
- marrëdhënia e saj me bashkëshortin nuk mund të konsiderohet si një “kontakt i papërshtatshëm”, i parashikuar si i tillë në nenin 3/6 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- duhet të merret në konsideratë që subjekti dhe shtetasi P. P., pavarësisht se janë bashkëshortë, janë qenie individuale;
- marrëdhënia mes një çifti bashkëshortësh është një marrëdhënie komplekse;
- në raport me çështjen e bashkëshortit të saj vlerëson se duhen marrë në konsideratë edhe vendimmarrje të tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në raste të ngjashme, ku vlerësimi i figurës së subjektit të rivlerësimit nuk është ndikuar nga situata e lidhjeve familjare të tij (rasti i gjyqtarës R. S., me vendimin nr. ***, datë 14.12.2020);
- të merret në konsideratë gjendja juridike në të cilën ndodhet çështja e bashkëshortit. Çështja nuk përbën “gjë të gjykuar”, pasi kjo çështje ndodhet ende në proces shqyrtimi, në Dhomë Këshillimi, në Gjykatën e Lartë. Për të mbështetur këtë argument ka referuar rastin, qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në çështjen e juridiksionit disiplinor për gjyqtarin L. D. dhe rastin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë SH. M., i cili ishte shkarkuar nga KLGJ-ja për shkak se ishte dënuar me vendim të formës së prerë dhe Komisioni ka vendosur të ndërpresë vazhdimin e procedurave të mëtejshme të këtij subjekti, për shkak të humbjes së statusit.

Subjekti, në vijim⁸³, duke i qëndruar deklarimeve që ka dhënë në shpjegimet e dërguara më parë⁸⁴, ka paraqitur pretendime shtesë lidhur me çështjen e bashkëshortit:

- lidhur me bashkëshortin pretendon se nuk ka ushtruar asnjë ndikim në punën e saj gjatë kohës që ushtronte profesionin e avokatit apo më pas. Kjo, sipas saj, bazuar në faktin se në vitet 2019 – 2020, bashkëshorti ka rezultuar me humbje nga kjo veprimtari dhe ka filluar të punojë si jurist pranë një subjekti privat. Për të provuar pretendimet ka dërguar disa dokumente⁸⁵;
- subjekti pretendon se qëndrimi i mbajtur prej saj nuk e cenon figurën si prokurore, parë edhe në aspektin kushtetues dhe konkretisht në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, pasi “E drejta për martesë dhe familje”, e parashikuar nga neni 53 i Kushtetutës nuk i nënshtrohet kufizimeve, për shkak të procesit të rivlerësimit;
- marrëdhëniet martesore dhe familja mbrohen nga Kushtetuta, por ato gëzojnë një mbrojtje të veçantë edhe nga “Konventa Europiane Për të Drejtat e Njeriut” (KEDNJ);
- subjekti pretendon se duke qenë se si rezultat i martesës kanë dy fëmijë të mitur, përveç mbrojtjes kushtetuese dhe KEDNJ-së, kjo marrëdhënie mbrohet nga “Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës” dhe ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- subjekti pretendon se ka vazhduar martesën me bashkëshortin për të mbrojtur “interesin më të lartë të fëmijëve”;
- subjekti referon një rast tjetër të ngjashëm, por mbi kriterin e pasurisë, vendimin nr. 20, datë 31.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për subjektin e rivlerësimit G. O.;

⁸³Datë 20.10.2021, pas njoftimit të Komisionit të datës 19.10.2021 “Ftesë për seancë dëgjimore të datës 22.10.2021”.

⁸⁴Datë 15.10.2021.

⁸⁵Formulari i deklaramentit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2019 dhe 2020. Llogaria rrjedhëse e bashkëshortit për vitin 2020.

- subjekti pretendon se në ngarkim të saj nuk ka asnjë kallëzim, procedim penal, masë disiplinore, ecuri disiplinore, etj. Gjithashtu, pretendon se denoncimet që janë bërë në drejtim të saj nuk kanë asnjë lidhje me figurën, por me shkaqe procedurale, madje edhe te këto ankesa nga Komisioni nuk është konstatuar asnjë shkelje.
- iii. Në lidhje me vëllain e saj A. Y. (me detyrë gjyqtar), sa i përket raportit të DSIK-së, subjekti ka pretenduar se: *“... e konstatoj tërësisht të qëllimtë përfshirjen e të dhënave të vëllait tim në vlerësimin e figurës sime, bërë me qëllimin e vetëm për të krijuar situata të disa familjarëve të mi, për të shkaktuar amulli dhe për të krijuar bindjen te ju se për shkak të tyre edhe unë jam e papërshtatshme në ushtrimin e detyrës”*.

Subjekti pretendon se nuk është i drejtë qëndrimi i DSIK-së që e gjykon atë për veprime që lidhen me vëllanë e saj, për të cilat përgjigjet vetëm ai dhe për të cilat është vetëm ai përgjegjës.

Lidhur me rubrikën “të dhëna për sigurinë”, germa “d”, në deklaratën për kontrollin e figurës, subjekti pretendon se e ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe jep disa shpjegime:

“Nuk e njoh, nuk e kam parë asnjëherë dhe nuk kam pasur kurrë asnjë kontakt, të asnjë forme apo mënyre me shtetasin K. M. . Për të provuar këtë pretendim ka bashkëlidhur disa dokumente⁸⁶.

Për të vërtetuar padijeninë time në lidhje me këtë fakt, bashkëlidhur po ju dërgoj një deklaratë noteriale të vëllait tim A. Y., ku evidentohet qartë se unë nuk kam qenë asnjëherë në dijeni për informacionin e referuar nga ai në deklaratën për kontrollin e figurës.

Vëllai im ka dhënë shpjegime për këtë person, në formularin e deklaramit të figurës, në rubrikën e pjesës 5, ‘të dhëna për sigurinë’ germa ‘ç’, ku pyetjes ‘A keni pasur kontakte të përshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në ushtrimin e detyrës tuaj?’, i është përgjigjur ‘Po’, duke e shpjeguar marrëdhënien me këtë person si ‘kontakt të përshtatshëm’.

Sqaroj faktin se unë në asnjë moment nuk kam qenë në dijeni të këtij kontakti, pasi në të kundërt, nëse do të isha në dijeni, nuk do të kisha asnjë shkak për ta fshehur këtë informacion”.

1.8 Subjekti ka paraqitur edhe disa akte shkresore që lidhen me punën dhe çështjet e ndjekura prej saj, me arsyetimin se pasqyrojnë të kundërtën e asaj që i atribuohet. Kjo me pretendimin që vlerësimi i figurës së saj të bëhet mbi bazën e rrethanave objektive.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.9 Vlerësimi i trupit gjykues, kryhet në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 38 të këtij ligji mbi “standardet e kontrollit të figurës” dhe raportit të DSIK-së.

1.10 Trupi gjykues, në analizë të argumenteve të subjektit lidhur me pasaktësinë e konstatuar në deklaratën për kontrollin e figurës (shtojca 3), në rubrikën “data, muaji, viti i lindjes” dhe dokumentacionit të administruar dhe verifikuar gjatë procesit hetimor (duke përfshirë edhe dokumentacionin identifikues të subjektit), vlerëson se qëndron pretendimi i subjektit se kemi të bëjmë me një gabim material/lapsus. Kjo, për faktin se duke verifikuar në këtë rast dhe krahasuar deklarinimin e subjektit për vitin e lindjes së saj, me deklarinimin në deklaratën *Vetting*,

⁸⁶Kërkesa e subjektit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me faktin nëse si prokurore pranë këtij institucioni ka mosfilluar, hetuar, pushuar dhe dërguar për gjykim, etj. çështje lidhur me atë person, si dhe shkresa nr. *** prot., datë 7.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

në deklaratat periodike vjetore, të dhënat e pasqyruara në certifikatën e saj personale, depozituar në dosjen e ILDKPKI-së, të cilat identifikojnë lehtësisht vitlindjen e subjektit 1979 dhe jo 1987, lehtësisht konstatohet se bëhet fjalë për një gabim, që nuk merr vlerë në këtë hetim administrativ, por mbetet thjesht dhe vetëm në nivel pasaktësie dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk ndikon në penalizimin e subjektit.

1.11 Gjithashtu, trupi gjykues, në lidhje me mosdeklarimet e subjektit për kontaktin e papërshtatshëm të vëllait të saj A. Y. me të tretë, në vlerësim: (a) të shpjegimeve të dhëna prej saj në prapësime; (b) të deklaratimit të bërë nga vëllai i saj në deklaratën noteriale⁸⁷ të depozituar nga subjekti, vlerëson të panevojshme daljen në konkluzion të kësaj çështjeje, për sa kohë vëllai i subjektit është njëkohësisht subjekt rivlerësimi dhe i nënshtrohet këtij procesi administrativ.

1.12 Sa i përket konstatimeve për papërshtatshmëri të subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës për shkak të dënimit të bashkëshortit të saj për “Korrupsion pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë është proceduar penalisht dhe dënuar”, trupi gjykues arsyeton dhe vlerëson si vijon:

Referuar parashikimit të bërë në germën “ç”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, në të cilin shprehimisht thuhet se “... rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur: ...(ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar”, subjekti i rivlerësimit në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të marrëdhënies bashkëshortore që ka me personin e lidhur, i cili përfshihet në këtë parashikim ligjor, nuk mund të shmanget nga papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës, për sa kohë bashkëshorti i saj kategorizohet në parashikimin e bërë në pikën 15, të nenit 3, të po këtij ligji. Nga ana tjetër, marrëdhënia bashkëshortore nuk hyn në kategorinë e marrëdhënieve të pashmangshme fisnore/me lidhje gjaku, por hyn në marrëdhënie familjare, që në këtë rast, ka mbetur e qëndrueshme nga vetë zgjedhja që ka bërë subjekti.

Trupi gjykues, pavarësisht pretendimeve të subjektit se lidhja bashkëshortore i ka diktuar qenien bashkë, ndarjen e një ambienti prindëror bashkë, çmon se lidhja e ngushtë e subjektit me bashkëshortin i dënuar për veprat penale sipas parashikimit të bërë në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, janë elementë që plotësojnë kushtet e nenit 38/4/ç për kontakt të papërshtatshëm dhe për rrjedhojë, në këtë rast gjen zbatim neni 61/2 i ligjit nr.84/2016.

Trupi gjykues, mbi bazën e disa konstatimeve të tilla si: (a) nuk u vërejt ndonjë reagim i subjektit në kohën e ndodhisë së çështjes penale të bashkëshortit të saj, qoftë edhe në publik, me qëllim distancimin e saj si prokurore për të përcjellë besueshmëri në vijimin e punës; (b) qenia e subjektit nën ekzistencën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, dhënë ndaj bashkëshortit të saj për akuzën “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, si dhe nën efektin e procesit të rivlerësimit, janë rrethana të cilat nuk e çbëjnë peshën ligjore që ato kanë shfaqur dhe ndikojnë për të krijuar një premisë të cenimit të publikut, pavarësisht faktit i) të deklaratimit në Deklaratën e Kontrollit të Figurës të dënimit të bashkëshortit, si dhe ii) moskonstatimit të problematikave në vlerësimin profesional.

Në këtë kontekst, rëndësia që merr gjendja aktuale dhe faktike e çështjes, e ndodhur përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë (deri aktualisht), që e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me burgim bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit (në kushtet e gjykimit të shkurtuar, kërkuar prej tij), për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në bazë të neneve 319/ç dhe 25 të Kodit Penal, vepër e cila përfshihet në krimin e organizuar, siç përcaktohet nga pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 si dhe detyra që ka pasur si prokuror dhe drejtues prokurorie, vlerësohen nga trupi gjykues për

⁸⁷Nr. ***rep., datë 13.10.2021.

subjektin e rivlerësimit, si rrethana që perceptohen negativisht në syrin e publikut dhe në kundërshtim me pritshmëritë dhe besueshmërinë e tij në figurën publike të një magjistrati, dhe si të tilla ato çmohen se cenojnë besimin e publikut, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr.84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë raport analizohen të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme; si dhe të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Analiza e gjetjeve⁸⁸

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurorja Ajola Prençi, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Prokurorja Ajola Prençi shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, duke përdorur arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale dhe shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurorja. Kështu, menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së

⁸⁸Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

subjektit të rivlerësimit, prokurorja Ajola Prençi, për vitet 2013, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurorja dhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi shfaq aftësi në arsyetimin ligjor.

Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve. Në arsyetimet ligjore prokurorja bën një analizë përveç normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale edhe të ligjeve specifike si në fushën e tatimeve.

Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Lidhur me tetë aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se nga ana e saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, provat e mbledhura, provat e paraqitura nga mbrojtja, si edhe kërkesat dhe pretendimet e mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 410 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 24.12.2019, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se nga prokurorja Ajola Prençi tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Subjekti Ajola Prençi ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurorja Ajola Prençi kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga subjekti i rivlerësimit, veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për t'u kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga prokurorja, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurores.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e rëna në short vihet re se komunikimi është i qartë dhe në përputhje me etikën e prokurorit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Ajola Prençi për vitet 2013, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Ajola Prençi rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

5. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin edhe është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, përgjithësisht, sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk vërejtí problematika, as edhe lidhur me etikën dhe integritetin e tij.

C/2 Mbi denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit

Në lidhje me katër denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:

1. Denoncim⁸⁹ i shtetasit P. N. P.

⁸⁹Nr. *** prot., datë 1.6.2020.

1.1 Në këtë denoncim shtetasi pretendon se në vitin 2014 është marrë si i pandehur në procedimin penal nr. ***/2013 edhe pse ishte në rolin e kallëzuesit të veprës penale. Gjithashtu pretendon se atij dhe familjes së tij i është bërë padrejtësi lidhur me një incident të ndodhur në qytetin e Fushë-Arrëzit, nga ku janë arrestuar edhe dy djemtë e tij.

Denoncuesi, në vijim, pretendon se me qëllimin për të liruar djemtë e tij ka marrë kontakt me gjyqtarin e çështjes, prokurorin e çështjes P. P. (bashkëshortin e subjektit), kancelaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe sekretaren e gjyqtarit dhe i ka paguar gjyqtarit dhe prokurorit shumën 30 milionë lekë. Në vijim, denoncuesi shpjegon se si pasojë e këtij fakti, prokurori P. P. është dënuar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 139/ç i Kodit Penal.

1.2 Sa më sipër, denoncuesi, në referim të deklaratës së pasurisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj (P. P.), evidenton apartamentin e përbashkët me sip. 92.4 m², në vlerën 8.491.566 lekë, në Tiranë, dhe ngre disa pretendime lidhur me datën e blerjes, burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, vlerën reale të tij dhe vlerën e mobilimit.

1.3 Lidhur me këto pretendime, denoncuesi ka bashkëlidhur DPV-në e vitit 2013 të subjektit dhe bashkëshortit, kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***/2013, të prokurorit N.T. drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (ku, ndër të tjerë, përfshihet në cilësinë e të pandehurit edhe bashkëshorti i subjektit) dhe vendimin e dërgimit të çështjes penale në gjyq (shkurt 2014).

1.4 Komisioni konstaton se pretendimet e denoncuesit lidhen me pasurinë nr. 2⁹⁰, të trajtuar më sipër në “vlerësimin e pasurisë” (pasuri e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2013).

1.5 Sa i përket pretendimeve lidhur me dënimin penal të bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues e ka trajtuar këtë çështje në rubrikën “kontrolli i figurës” të subjektit të rivlerësimit dhe, për këto arsye, në tërësi ky denoncim nuk evidenton fakte apo rrethana lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncim⁹¹ i shtetas L. L.

2.1 Në denoncimin e saj shtetasja kryesisht ankohet për subjekte të tjera (gjyqtarë dhe prokurorë) lidhur me vendimmarrje gjyqësore të paligjshme (duke cituar disa vendime gjyqësore) dhe abuzim me detyrën në gjykimin e çështjeve, si dhe për vendimmarrjen e disa prokurorëve lidhur me pushime të hetimeve të iniciuara mbi bazën e kallëzimeve të denoncueses ndaj palëve të përfshira në konfliktet e pronësisë.

2.2 Nga analizimi i pretendimeve konstatohet se bëhet fjalë për një konflikt pronësor që denoncuesja ka me palën e paditur, shtetasit F. T.(B.) dhe E.B., për një pronë në zonën e R. .

Ndër të tjera, denoncuesja pretendon se ka bërë disa kallëzime penale ndaj këtyre shtetasve (për ndërtim pa leje, shkatërrim prone, prerje e paligjshme e pyjeve, përdorim dokumentesh të falsifikuara), por hetimet janë zgjatur dhe/ose janë pushuar.

2.3 Në këtë kuadër, denoncuesja përmend gjashtë prokurorë, ndër të cilët edhe subjektin e rivlerësimit, por pa specifikuar problematika ose pretendime për paligjshmëri lidhur me veprimet konkrete të ndërmarra nga subjekti.

⁹⁰Apartament në pronësi me sip. 92.4 m², në adresën: rruga “*****”, shk. ***, k. ***, h. nr. ***, godinë 9-katëshe, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, blerë në vitin 2013 me çmimin 8.491.560 lekë.

⁹¹Nr. *** prot., datë 15.2.2019.

2.4 Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit disa vendime gjyqësore administrative dhe civile (të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër), si dhe aktin administrativ të ZVRPP-së Malësi e Madhe.

2.5 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi fakte apo rrethana, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim⁹² i shtetases T. Ç.

3.1 Në denoncimin e saj kjo shtetase ankohet për proces jo të rregullt ligjor ndaj disa gjyqtarëve dhe subjektit të rivlerësimit dhe për shkelje të etikës profesionale, pasi është fyer në zyrën e gjyqtarit (subjekt tjetër), pa dhënë specifika të tjera.

3.2 Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit: kërkesëpadinë me palë të paditur përmbarese znj. E.M. (në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër); disa vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; vendim pushimi të procedimit penal nr***, në datat 10.6.2013 dhe 27.9.2013; vendimin për mosfillimin e procedimit penal datë 11.12.2013 (nga subjekt tjetër); dokumentacionin nga DRSSH-ja Shkodër; vendimin nr. ***, datë 12.2.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; dokumentacionin përmbarimor për veprimet e ndërmarra nga përmbarese E. M.; dokumentacionin e DRSSH-së Shkodër; dhe dokumentacionin bankar.

3.3 Referuar dokumentacionit të përcjellë bashkëlidhur denoncimit, duket se problematikat e denoncueses lidhen me përlllogaritjen e gabuar të pensionit të bashkëshortit të saj të ndjerë, përfituar prej saj dhe procedurat gjyqësore të ndjekura prej saj, duke iniciuar edhe kallëzime penale.

3.4 Referuar dokumentacionit, lidhur me pretendimin për përlllogaritje të gabuar të pensionit (duke pretenduar se shuma e pensionit duhet të ishte më e madhe), i është drejtuar, fillimisht, me kërkesë Komisionit Qendror të Ankesave pranë ISSH-së Tiranë, i cili ka vendosur mospranimin e kërkesës⁹³.

Në vijim, denoncuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka paditur Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr***, datë 31.5.2011, ka vendosur pranimin e pjesëm të kërkesëpadiisë dhe ka lënë disa detyra për DRSSH-në Shkodër.

Denoncuesja, në vijim, rezulton të ketë pasur pretendime lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi nga DRSSH-ja Shkodër dhe ka kërkuar urdhërekzekutimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila e ka pranuar dhe ka ndjekur procedurat me përmbaruesen E. M. .

3.5 Denoncuesja referon problematika lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor nga përmbaresja gjyqësore E. M., duke pretenduar se kjo e fundit i ka ekzekutuar vendimin gjyqësor fshehurazi (pa e informuar) dhe nuk i ka kthyer detyrimin që i takon. Në adresë të përmbareses, denoncuesja ka bërë padi dhe kallëzime penale.

3.6 Për njërin nga këto kallëzime penale, në kuadër të të cilit është iniciuar procedimi penal nr. ***, datë 10.6.2013, ndaj përmbareses, me objekt veprën penale “pengim i ekzekutimit të vendimit gjyqësor⁹⁴” (neni 320 i Kodit Penal), subjekti i rivlerësimit ka dalë me vendim pushimi datë 27.9.2013, për mungesë të figurës së veprës penale.

3.7 Rezulton se në vendimin e pushimit të subjektit të rivlerësimit janë arsyetuar veprimet hetimore të kryera, përfshirë edhe aktekspertimin kontabël.

⁹²Nr. *** prot., datë 25.6.2018.

⁹³Me aktin nr. ***, datë 12.7.2010.

⁹⁴Referuar vendimit nr. ***, datë 31.5.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3.8 Subjekti është pyetur⁹⁵ lidhur me qartësimin e statusit aktual të çështjes, pra, nëse ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim. Gjithashtu, është kërkuar të depozitohë dokumentacionin mbështetës për shpjegimet e saj.

3.9 Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar kopje të fashikullit penal. Në shpjegimet e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se ndaj vendimit të pushimit nuk është ushtruar ankim dhe për ta konfirmuar këtë fakt i ka bashkëlidhur pyetësorit përgjigjen e dhënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. ***prot./J.B., të datës 5.8.2021.

3.10 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar, si dhe përgjigjeve në pyetësor, konkludon se subjekti ka kryer veprime të plota hetimore në favor të një hetimi shterues. Në kushte të tilla nuk diktohen problematika lidhur me këtë çështje, çka do të thotë se nuk cenohet pozita e subjektit lidhur me vlerësimin e tij profesional.

4. Denoncim⁹⁶ i shtetasit I.T.

4.1 Në denoncimin e tij shtetasi i referohet një ngjarjeje të ndodhur në datën 23.9.2015, në M., Laç, ku ka mbetur i vranë një person dhe të plagosur dy të tjerë (referuar si kushërinjtë T.) nga tre vëllezërit M. . Duket që denoncuesi ka lidhje familjare me personat e dëmtuar.

Denoncuesi ankohet se është mbajtur një qëndrim jo i drejtë ndaj palëve të dëmtuara nga vepra penale, duke kërkuar dënimin e tyre me 24 vjet burgim. Në vijim pretendon se akuza nuk është bazuar në prova dhe është e njëanshme. Denoncuesi ankohet kryesisht ndaj subjekteve të tjera, në cilësinë e prokurorit dhe gjyqtarit.

4.2 Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit një sërë dokumentesh procedurale penale (kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***/2015, nënshkruar nga një prokuror tjetër, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, vendime gjykatash, aktekspertimi mjeko-ligjor, aktekspertime nga ekspertët kriminalistë, procesverbal i këqyrjes së vendngjarjes) që nuk lidhen drejtpërdrejt me subjektin e rivlerësimit.

Në adresë të subjektit të rivlerësimit denoncuesi ka paraqitur vetëm diskutimet përfundimtare në gjykatë.

4.3 Nga analizimi i këtij akti dhe pretendimeve të denoncuesit, duket se subjekti ka kërkuar dënime maksimale me burgim për personat në cilësinë e të pandehurve (duke përfshirë të dyja palët e përfshira në konflikt), pa treguar elemente njëanshmërie.

4.4 Duket se subjekti ka përfaqësuar prokurorin në fazën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

4.5 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstatoi fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

4.6 Trupi gjykues, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

⁹⁵Pyetësor nr. 3, datë 30.7.2021.

⁹⁶Nr. *** prot., datë 12.12.2017.

VLERËSIM TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Ajola Prençi:

- a) Nuk ka arritur nivel të besueshëm sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, sa i takon kriterit të pasurisë;
- b) Për kriterin e kontrollit të figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kontakte me person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe që e bën të pamundur vazhdimin e detyrës; dhe se,
- c) Në vlerësimin tërësor të problematikave të analizuara më lart, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ajola Prençi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, aktualisht Lezhë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 1.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta